



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i
Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”
ofruar nga Universiteti i Arteve**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. As. Dr. Rrezeart Galica
2. Dr. Elida Begaj

Two handwritten signatures in blue ink are positioned to the right of the list. The first signature, corresponding to Prof. As. Dr. Rrezeart Galica, is written in a cursive style. The second signature, corresponding to Dr. Elida Begaj, is also in a cursive style and is written below the first one.

Tetor 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi” ofruar nga
Universiteti i Arteve

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Arteve
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Skulpturës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr 397, datë 10.08.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMASR Nr 821, datë 26.12.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASR Nr 156, datë 19.09.2013
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Nuk ka
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 (Dy) vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Programi ofrohet vetëm nga UART
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Nuk është Diplomë e përbashkët
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Nuk është Diplomë e dyfishtë
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	7 PAE/2PAK
18	Numri i studentëve:	2020-21 7 studentë 2021-22 4 studentë 2022-23 8 studentë

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi“, është objekt i vlerësimit për herë të parë në kuadër të akreditimit të tij.

Në përputhje me tregun e punës, Departamenti i Skulpturës, si një nga tre njësitë bazë të Fakultetit të Arteve të Bukura, propozoi riorganizimin e këtij programi duke e ofruar edhe në fushën e Mësuesisë. Riorganizimi i programit u realizua së bashku me të gjitha programet e tjera të ciklit të dytë që ofrohen në të gjithë Universitetin e Arteve me UMASR Nr 821, datë 26.12.2018 ‘Për riorganizimin e programeve të studimit të Ciklit të Dytë në Universitetin e Arteve’ dhe programi në fjalë, objekt vlerësimi i GVJ riorganizohet me emërtimin Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi’

Programi i studimit ofrohet në gjuhën shqipe dhe realizohet me 120 kredite duke u shtrirë në dy vite akademike (4 semestra) në përfundim të të cilit studenti pajiset me diplomë Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi’.

Objektivi kryesor i këtij programi është pajisja e studentëve me instrumenta teorikë dhe artistikë/kulturorë, për të krijuar një dinamikë shprehëse nëpërmjet medimeve të ndryshme, duke i përfshirë ato në harkun e gjërë të rritjes së komunikimit pamor. Profilizimi i një tjetër kulture të humanizmit të veprës së artit përmes karakteresh të vrullshëm dhe qëndrimesh të reja, e bëjnë këtë program të ndjehet konkurrues në marrdhënie me zhvillimet e kulturës bashkëkohore

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Në Universitetin e Arteve, Tiranë, më 12 dhe 13 Dhjetor, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi vizitën për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të dytë Masteri Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”. Vlerësimi i këtij program studimi bëhet për herën e parë nga ASCAL-i. Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) për këtë program studimi u përgatit nga dy profesorë me përvojë dhe ekspertë të fushës: Prof.As. Rrezeart Galica dhe Dr. Elida Begaj. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua edhe nga koordinatoresha teknike e ASCAL, Znj. Aleksandra Xhamo.


Për të kryer vlerësimin, GVJ-ja u mbështet në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB), bashkëshoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe në takimet me të gjithë aktorët përgjegjës për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e këtij programi studimi. Që në fillim do të donim të theksonim punën e mirë që është bërë për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë, po të kemi parasysh se është përvoja e parë e këtij departamenti që mbulon këtë program studimi. RVB-ja është ndërtuar në frymë kolegjiale, me objektivitet dhe janë bërë përpjekje që ai të pasqyrojë me vërtetësi gjendjen aktuale të cilësisë së programit të studimit, stafit akademik dhe atij administrativ si dhe të infrastrukturës mbështetëse. RVB-ja është ndërtuar duke përdorur të gjitha burimet e nevojshme, duke e mbështetur çdo pohim në shkresën përkatëse si dhe duke përdorur drejt terminologjinë e fushës së vlerësimit të cilësisë.

Programi i studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi” është hartuar dhe zbatohet në përputhje me kërkesat e Ligjit të AL 80/2015, të akteve nënligjore dhe të urdhrave e rekomandimeve të Senatit Akademik dhe Rektoratit të Universitetit të Arteve. Disiplinat shkencore që përbëjnë këtë program studimi janë planifikuar të ndara me syllabuse dhe ngarkesa në ETCS. GVJ-ja vëren se ka vend ende për përmirësim, veçanërisht të raportit të ngarkesës mësimore. Gjithashtu, GVJ-ja la rekomandimin për organizimin e një auditi të brendshëm.

Departamenti i Skulpturës, Fakulteti i Arteve të Bukura në Universitetin e Arteve ka në përbërje staf akademik me përvojë dhe të kualifikuar që i përballon shumë mirë kërkesat shkencore që shtrihen ky program studimi. Po kështu ka në përbërje profesorë me përvojë akademike dhe pedagogjike që janë mbështetje e madhe për promovimin e më të rinjve. GVJ-ja vërejt se puna shkencore e stafit akademik është e shtuar gjatë një viti akademik si dhe stafi është i përfshirë në shumë projekte e trajnime ndërkombëtare.

Sfida me e madhe që duhet të zgjidhë në të ardhmen ky departament është tërheqja e më shumë studentëve në këtë program studimi.


Megjithëse pas zhvillimit të këtij program studimi, Master, studenti ka mundësinë e punësimit në sistemin arsimor. Strukturat përkatëse të Universitetit të Arteve duhet të jenë më në kontakt me të diplomuarit (alumni) dhe të krijojnë databazën për këtë.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”, është hapur referuar Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, Programi i ofruar nga Universiteti i Arteve si i vetmi Institucion i Arsimit të Lartë Publik në vend. Riorganizimi i tyre është realizuar sipas Urdhrit të MASR nr. 821, datë 26.12.2018, “Për riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin Arteve”. GVJ Ju tha se qëllimi i riorganizimit të programeve studimore është për t’u përafuar sa më shumë me tregun e punës, duke iu ofruar programeve të studimit në fushën e mësuesisë dhe reflekton prioritetet e zhvillimit në vend.</p> <p>Univeristeteti i Arteve ofron programe në fushën e arteve që synojnë ruajtjen e konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare.</p> <p><i>Evidencë. Nr.5.2. (Urdhri i MASR Nr. 821, datë 26.12.2018 “Për riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin Arteve”. pdf)</i></p> <p><i>Evidencë. Nr.13.(Rregullorja e Programit të studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”. pdf)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Misioni i programit të studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi” përputhet me qëllimet dhe misionin e Universitetit të Arteve.</p> <p>Qëllimi kryesor i këtij programi është:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Ofrimi i arsimit të lartë profesional dhe veprimtarive krijuese e artistike/kërkimore shkencore në fushën e artit dhe të kulturës mbështetur mbi kërkesat gjithnjë e në rritje të një mësimdhënie sa më cilësore në Shqipëri; ● Thellimi i kualifikimit të veprimtarive krijuese e artistike/kërkimore shkencore në fushën e artit dhe të kulturës së studentit, në fushën e mësuesisë dhe edukimit artistik. <p>Përgjatë vizitës në Institucion GVJ-ja komunikoi me organet drejtuese të programit të studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”. Ky program studimi në gjithë veprimtarinë e tij synon në mënyrë të vazhdueshme të arrijë standardet akademike më të larta bashkëkohore, kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky program përkrah arritjet e studentëve, duke i nxitur ata të rrisin nivelin e tyre të formimit dhe të kualifikimit, duke gërrshetur njohuritë teorike dhe praktike.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 21. (Plani mësimor dhe ngarkesa mësimore e Programit të studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”.pdf)</i></p>




	<p><i>Evidencë. Nr.2. (Vendim nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë. pdf”</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Plani i zhvillimit strategjik të UT (<i>Evidencë Nr.14. Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025</i>) informon se programi i studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi” është hartuar dhe ofrohet duke u bazuar në ligjin për Arsimin e Lartë nr.80/2015 dhe gjithë kuadrin nënligjor në zbatim të këtij ligji, në VKM-së nr. 145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e UART, Rregulloren e UART, Rregulloren e njësisë kryesore, Rregulloren e cikleve të studimit si dhe një sërë aktesh rregullatorë të tjera të UART, të cilat përbëjnë bazën ligjore të funksionimit e mbarëvajtjes së veprimtarisë mësimore, artistike/kërkimore e shkencore si dhe administrative të UART.</p> <p>Sipas planit të zhvillimit strategjik të UART, vizioni i tij orientohet drejt integritimit rajonal, europian dhe global. Fokusi i programit mbështetet në traditë. Ky vizion dhe fokus e bën programin e studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi” në Universitetin e Arteve, të konkurojë me produktin e tij në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar.</p> <p><i>Evidencë Nr.14. “Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025”</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Pra, Programi i studimit Master i Arteve në Skulpturë dhe Mësuesi mbështetet në Strategjinë e zhvillimit të Universitetit të Arteve, <i>Strategjinë Kombëtare për zhvillim dhe Integrim 2015-2020</i> (https://www.dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/278-strategjia-kombetare-per-zhvillim-dhe-integrim), në disa parashikime të Draft Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026 (https://arsimi.gov.al/draft-strategjia-kombetare-e-arsimit-2021-2026/).</p> <p>Andaj, në përputhje me strategjitë e parashikuara në nivel kombëtar dhe ato në nivel ndërkombëtar, programi i studimit Master i Arteve në Skulpturë dhe Mësuesi është konceptuar që të përshtatet sa më shumë me tregun e punës, duke krijuar kushte të barabarta për të gjithë kandidatët e mundshëm, dhe duke zhvilluar marrëdhënie bashkëpunimi në fushën e edukimit dhe kërkimit artistiko-shkencor me Universitete dhe Institucione në Evropë duke ofruar mundësi ndërkombëtarizimi.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 7. Statuti i UART</i> <i>Evidencë. 45. 1. Parashikimi i kuotave të pranimit, VSA . 17, dt. 10.03. 2022</i> <i>Evidencë. 5.2 Urdhri i MAS Nr. 821, datë 26.12.2018 “Për riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin Arteve”</i> <i>Evidencë. Nr.19. Marrëveshjet ndërmjet institucioneve të artit në Shqipëri.</i> <i>Evidencë. Nr.17-18 Marrëveshjet dypalëshe ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë në vend.</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




	http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=1090 http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=1091			
Konkluzione	GVJ arrin në përfundimin se programi i studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”, është në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Pra, Fakulteti i Arteve të Bukura ka mbi 60 vjet që ushtron aktivitetin e tij në fushën e arsimit të lartë dhe vërtetohet se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura njerëzore në programin e studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”.</p> <p>Bazuar te dokumentacioni, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se ky fakultet ka personel akademik të kualifikuar dhe infrastrukturë funksionale për realizimin të këtij programi studimi.</p> <p>Personeli Akademik Efektiv, në nivel fakulteti, përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● 2 Profesorë, ● 0 Profesor i Asociuar, Dr. ● 2 Profesorë të Asociuar, ● 1 Lektor me gradën Dr./PhD, dhe nga ● 3 Asistent Lektorë. <p>Ndërsa Personeli Akademik me Kontratë përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● 2 Profesor ● 0 Profesor i Asociuar, Dr. ● 1 Lektorë me gradë Dr., ● 3 Asistent Lektorë. <p>Në programin e studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”, për vitin akademik 2021-2022 janë angazhuar në total 9 staf akademik, prej të cilëve 2 me titullin profesorë, 2 me titullin Asoc. Prof., 1 Lektorë me gradën Dr./PhD dhe 3 Asistent Lektor.</p> <p><i>Evidencë. Nr.16. Tre tabelat e stafit akademik për vitet 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022.</i></p> <p>http://uart.edu.al/media/2021%20-%20FAB%20PERSONEL%20AKADEMIK.pdf</p>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e	Fusha e përgjithshme e programit të studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”, është fusha e Skulpturës, e cila është në përputhje me fushën studimore akademike artistike/kërkimore dhe shkencore të njësisë kryesore, Fakultetit të Arteve të Bukura, përgjegjëse për programin e studimit, sipas


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




<p>kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Fusha specifike e programit të studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”, është në përputhje me fushën akademike artistike/kërkimore e shkencore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e këtij programi studimi është në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, si përmbledhje e standardeve shtetërore për sigurimin e cilësisë, për programet e studimit "Master i Arteve"; Manualit për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të IAL dhe programeve të studimit 2017; si dhe Udhëzuesit dhe Standardet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (European Standards and Guidelines-ESG 2015, https://www.enqa.eu/wp-content/uploads/filebase/esg/ESG%20in%20Albanian_by%20KAA.pdf)</p> <p>Evidencë. 4. VKM Nr.824, dt 24.12.2021 Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë.</p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Fusha e përgjithshme e programit të studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”, është fusha e skulpturës. Ajo është në përputhje me fushën akademike e studimore të njësisë bazë, Departamentit të Skulpturës.</p> <p>Evidencë. Nr.16. 1 Tabelat e stafit akademik sipas lëndëve për programin e studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi” për vitet 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022.</p>			
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Nuk aplikohet ky kriter për këtë program, pasi është Master i Arteve</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Universiteti i Arteve nuk ofron trajnime profesionale apo programe studimi të ciklit të vazhduar.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi” është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë, përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">x</p>



Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ-ja konstatoi se në Fakultetin e Arteve të Bukura, në fillim të çdo viti akademik, njësitë kryesore diskutojnë problematikat, zgjidhjet dhe prioritetet e çdo njësie bazë në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor, ngarkesës së stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesëshme, detyrat dhe përgjegjësitë e personelit ndihmës akademik si dhe personelit administrativ.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ-ja gjithashtu, konstatoi se departamenti i Skulpturës, për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi” ka siguruar dhe siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda Universitetit, ku evidentohen: personeli akademik e strukturat mbështetëse si:</p> <p>Sekretaria mësimore, e cila është në funksion të studentëve jo vetëm të këtij pogrami studimi por në funksion të studentëve të të gjitha programeve që ofrohen në Fakultetin e Arteve të Bukura; Biblioteka e UART; Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Informacion, Protokoll dhe Arkiv; Sektori Mësimor i Kurrikulës, Këshillimit të Karrierës, Informimit të Studentëve dhe Alumni; Sektori i Statistikës; Sektori i Teknologjisë së Informacionit; Sektori i Sallave dhe Shërbimeve Mbështetëse; Sektori Juridik, etj</p> <p>Evidencë. Nr.15. Raporti vjetor i Departamentit të Skulpturës</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ-ja konstatoi se Universiteti i Arteve ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi në fushën e edukimit dhe kërkimit artistik/shkencor me disa Universitete dhe Institucione në Evropë që janë realizuar e formalizuar në kuadrin e marrëveshjeve dypalëshe apo edhe jashtë tyre. Universitetet, Akademitë me të cilat bashkëpunon institucioni janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Marrëveshje Kuadër ndërmjet Universitetit të Arteve dhe Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë; ● Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Conservatoire national supérieur de musique et de danse de Paris dhe Universitetit të Arteve; ● Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë, Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim; Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet UART dhe Festivalit të Filmit në Shkup CINEDAYS; ● Memorandum Mirëkuptimi midis Zhejiang Normal University in Jinhua, Zhejiang, China; ● Protokoll i Bashkëpunimit të Universitetit të Arteve të Bukura “Mimar Sinan” dhe Universitetit të Arteve, Universitetin ‘Aleksandër Moisiu’ Durrës; ● Universitetin ‘Luigj Gurakuqi’ Shkodër;



	<ul style="list-style-type: none"> Shkollën kombëtare artistike “Jordan Misja” . <p>Këto bashkëpunime mundësojnë jo vetëm ndërkombëtarizimin e programit të studimit, por dhe ndikojnë pozitivisht në mobilitetin akademik dhe të studentëve. Universiteti i Arteve ka marrë pjesë rregullisht në programin e mëhershëm Tempus, dhe vitet e fundit ka disa marrëveshje partneriteti në kuadër të projektit Erasmus+ mbështetur financiarisht nga BE.</p> <p>Evidencë. Nr. 17-20. UART në marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të projektit Erasmus dhe Erasmus +.</p>								
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se për realizimin e praktikave mësimore të programit të studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”, janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe si dhe ato të Zyrave Vendore Arsimore.</p> <p>Pjesa më e madhe e studentëve të këtij programi, i ka kryer praktikat mësimore pranë shkollave të mesme, të cilat kanë mundur zbatimin e teorisë në praktikë, dhe konkretizimin e dijeve të përftuara në këtë program.</p> <p>Evidencë. Nr.19. Marrëveshje bashkëpunimi të Fakultetit të Arteve të Bukura me Institucionet arsimore ZVA-të</p>								
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga Grupi i Vlerësuesve të brendshëm, por dhe vizitës në institucion, GVJ-ja konstatoi se Departamenti i Skulpturës, në bashkëpunim edhe Dekanatin e Fakultetit të Arteve të Bukura, në mënyrë periodike, analizon përfitimën e marrëdhënieve të bashkëpunimit, dhe harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit dhe të objektivave të këtij programi studimi.</p> <p>Evidencë. Nr. 20. Raport mbi marrëveshjet e bashkëpunimit</p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						


<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimi Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi” është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me udhëzimet e MAS, me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Lëndët e këtij programi janë kategorizuar në katëgoritë:</p> <p>A-Lëndë Bazë; B-Lëndë Karakterizuese; C-Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese; D-Lëndë Plotësuese; E-Detyrime Përmbyllëse.</p> <p>Kreditet janë në përputhje me përqindjen e parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Në përfundim të studimeve të tyre studentët e këtij programi grumbullojnë 120 ECTS.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 21. Plani mësimor dhe ngarkesa mësimore e programit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ-ja konstatoi se realizimi i programit mësimor mbështetet në metodat e mësimdhënies që venë theksin tek studenti, duke i ofruar atyre koncepte e njohuri të përparuara dhe shprehi praktike në fushën e artit dhe edukimit.</p> <p>Nëpërmjet programit dhe përmbajtjes së lëndëve, metodave të mësimdhënies, detyrave të kursit, praktikave profesionale të studentëve jashtë universitetit synohet që t’u jepen studentëve njohuri të përparuara akademike në artin pamor edhe në fushën e mësuesisë. Disa nga lëndët artistike e profesionale që diferencojnë këtë program janë: Skulpturë Monumentale, Skulptura Interior, Exterior.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 22. Kurrikulat e programit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Lëndët që përfshihen në kurrikulën e këtij programi studimi janë të organizuara sipas kategorive (A-E), me peshën e përcaktuar në Shtojcën 1 të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL” e ndryshuar.</p> <p>Në këtë program studenti merr:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● 12 kredite për lëndët e kategorinë A, ● 15 kredite për lëndët e kategorisë B, ● 8 kredite për lëndët e kategorisë C, ● 3 kredite për lëndët e kategorisë D, dhe

	<ul style="list-style-type: none"> • 84 kredite për detyrimin përmbyllës që është kategoria E, e cila është diploma. <p>Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit. Ngarkesa për një vit akademik është 60 kredite.</p> <p>Programi i studimit përcakton ngarkesën në kredite të dedikuara për realizimin e praktikës profesionale mbi bazën e kriterëve të përcaktuara nga Ligji për Arsmin e Lartë, nr.80/2015, datë 22.07.2015 dhe VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Praktika mësimore parashikohet si pjesë e planit mësimor dhe përmban një numër kreditesh të caktuara (3 kredite) ose (75 orë) dhe studentët e kanë të detyrueshme kryerjen e saj.</p> <p>Praktikat profesionale zhvillohen në Institucione sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e Personelit Akademik të caktuar nga Departamenti përkatës. Çdo hap i zhvillimit të praktikës është parashikuar në rregulloren e përgjithshme, dhe në rregulloren e fakultetit.</p> <p>Evidencë 4: Rregullore Mësimore e UART, Kreu VII, neni 29, pika 1,2,3, 4,5,6</p> <p>Evidencë. Nr.5: Rregullore Mësimore FAB, Kreu IV, Neni 38, neni 39</p> <p>Evidencë. Nr. 21. Plani mësimor dhe ngarkesa mësimore e programit të studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësimi i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Programi i studimit i ciklit të dytë me kohë të plotë Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”, i pajis studentët që zotërojnë diplomën universitare Bachelor në “Skulpturë dhe Mësuesi” me njohuri të thelluara artistike-shkencore-teorike dhe praktike sipas drejtimin përkatës, trajnim për kërkim të pavarur në një fushë brenda specialitetit, arsimim dhe trajnim të mëtejshëm profesional. Programet e studimit në ciklin e dytë janë programe universitare të formimit artistik të cilat ofrojnë edhe studime në fushën e mësuesisë, i mundëson studentëve të drejtën për punësim, si mësimdhënës në lëndët e artit, pranë institucioneve të arsimit parashkollor, ciklit të ulët dhe të ciklit të mesëm.</p> <p>Evidencë. Nr. 7. Statuti i UART</p> <p>Evidencë. Nr.13. Rregullorja e programit të studimit programit të studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Programet e studimit të ciklit të dytë përfshijnë edhe fushën mësuesisë dhe janë të organizuara me 120 ECTS, me kohëzgjatje 2 vite akademike, në sistemin e studimeve me kohë të plotë (60 kredite për çdo vit akademik).</p> <p>Këto programe përmbajnë 25% të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik të shprehura si më poshtë:</p> <p>Kategoria A-Lëndë Bazë, 28 ECTS, (në dy vite) nga të cilat lëndët e formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik 24 ECTS:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Metodologji e mësimdhënies – 6 ECTS. • Teoritë e të nxëniet & Menaxhimi Klasës – 6 ECTS

	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi në Arsim – 4 ECTS • Zhvillim Kurrikulës – 4 ECTS • Psikologji Zhvillimi Moshave – 4 ECTS <p>Kategoria D- Lëndë me Zgjedhje dhe Lëndë Plotësuese, 14 ECTS, (në dy vite) nga të cilat lëndët e formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik 6 ECTS:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Praktikë Mësimore – 6 ECTS <p>Në total lëndët e formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik përmbajnë 30 ECTS, pra 25% të krediteve, në këtë drejtim.</p> <p>Evidencë. Nr. 21 Plani mësimor dhe ngarkesa mësimore për programin e studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”.</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Universiteti i Arteve, ndjek politikat për pranimin e studentëve, që bazohet në Strategjinë Kombëtare të Arsimit të Lartë, Ligjin për Arsimin e Lartë dhe prioritetet e tre Fakulteteve të Universitetit të Arteve, duke vlerësuar kapacitetet e mundshme për çdo vit akademik.</p> <p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ-ja konstatoi se në Universitetin e Arteve, pranimi i studentëve kryhet nëpërmjet konkurseve të pranimit, kriteret e të cilave hartohen nga Departamentet, miratohen në Senatin Akademik të UART, dhe dërgohen në MAS. Ministria e Arsimit dhe Sportit, miraton kuotat e dërguara nga UART, dhe nxjerr Udhëzimin përkatës për afatet dhe zhvillimin e konkurseve të pranimit mbi bazën e rregulloreve dhe kriterëve të UART për këtë proces. Me Vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen tarifat e shkollimit për secilin program studimi të ofruar në UART.</p> <p>Te gjitha këto hapa e procedura, pasqyrohen dhe në faqen zyrtare online, të institucionit.</p> <p>Universiteti i Arteve, ndjek një politikë mbështetëse për studentët me aftësi ndryshe. Sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, parashikohen kriteret për përfitimin e bursave në bazë të kategorive përkatëse, të cilat ndryshojnë çdo vit akademik. Sipas statistikave të ruajtura në sekretarinë e FAB në nivelin Bachelor:</p> <p>Në vitin 2020-2021 - 3 studentë me aftësi ndryshe. Në vitin 2019-2020 - 2 studentë me aftësi ndryshe.</p> <p>Sipas statistikave të ruajtura në sekretarinë e FAB në nivelin Master: Në vitin 2019-2020 rezultojnë 1 student me aftësi ndryshe.</p> <p>Për studentët që vijnë nga shtresa sociale “Rome/Ballkano-Egjiptiane”, UART ndjek politikë mbështetëse për këtë kategori, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në zbatim të këtyre akteve parashikohen kriteret për përfitimin e bursave në bazë të kategorive përkatëse, të cilat ndryshojnë çdo vit akademik</p> <p>Sipas statistikave të ruajtura në sekretarinë e FAB në nivelin Bachelor: Në vitin 2020-2021 - 1 student i kategorisë Rome.</p> <p>Evidencë. Nr. 24. Konkurent, fitues dhe Udhëzim-nr.17-datë-30.7.2019 Për përjashtimin e nga pagesa të studentëve; Romë/Ballkano – Egjiptianë.</p> <p>http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=135&niveli=78</p>



Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Universiteti i Arteve, Fakulteti i Arteve të Bukura, Departamenti i Skulpturës nuk ofron programe të Ciklit të Dytë Master në të njëjtën fushë studimi si dhe me të njëjtën emërtesë.		
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi” shoqërohet me kodin përkatës sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike me anë të VKM Nr. 330, datë 11.05 2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë” Evidencë. Nr. 25. Tabela e kodifikimeve sipas VKM		
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Universiteti i Arteve, Fakulteti i Arteve të Bukura, Departamenti i Skulpturës nuk ofron programe të Ciklit të Dytë Master midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë vendas apo të huaj.		
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi” është organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Universiteti i Arteve përfaqëson një strukturë të integruar dhe të përbërë nga njësi kryesore të cilat përbëhen secila nga njësi bazë dhe struktura të tjera ndihmëse me karakter akademik dhe administrativ. Universiteti i Arteve respekton Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2014 legjislacionin në fuqi si edhe përcaktimet statutorë. Fakulteti i Arteve të Bukura ofron programe të studimeve të cikleve të ndryshme, në përputhje me objektivat e tij akademik dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve. Ky fakultet organizohet në jo më pak se tre njësi bazë, ku së paku dy prej të cilave janë departamente. Funkcionet e tyre përcaktohen në rregulloren e fakultetit. Fakulteti i Arteve të Bukura përbëhet nga: <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Arteve të Aplikuara • Departamenti i Pikturës • Departamenti i Skulpturës Për Fakultetin e Arteve të Bukura, numri i stafit akademik me kohë të

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al

	<p>plotë i ndarë sipas Departamenteve paraqitet si më poshtë: Fakulteti i Arteve të Bukura – 37 pedagogë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Arteve të Aplikuara – 15 pedagogë • Departamenti i Pikturës – 15 pedagogë • Departamenti i Skulpturës – 8 pedagogë <p>Kualifikimi i pedagogëve në Departamentin e Skulpturës është si më poshtë: Prof. 2 Pedagogë Prof. Asoc. 2 Pedagogë Dr. 1 Pedagogë As. Lek 3 Pedagogë</p> <p>Numri i pedagogëve me kohë të pjesshme paraqitet si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Arteve të Aplikuara – 6 pedagogë • Departamenti i Pikturës – 9 pedagogë • Departamenti i Skulpturës – 2 pedagogë Sipas viteve akademike, përbërja e Departamentit të Skulpturës është si më poshtë:</p> <p>Viti akademik 2019 – 2020 PAE 2 Prof. 2 Prof. Asc. 4 As. Lektor</p> <p>PAK 1 As. Lektor</p> <p>Viti akademik 2020 – 2021 PAE PAE 2 Prof. 2 Prof. Asc. 4 As. Lektor</p> <p>PAK 1 As. Lektor</p> <p>Viti akademik 2021 – 2022 7 PAE 1 Prof. Asc. 2 Prof. Asc. 4 As. Lektor</p> <p>PAK 2 As. Lektor</p> <p><i>Evidencë. Nr. 1 Ligji për arsimin e lartë 80/2015</i> <i>Evidencë. Nr. 7. Statuti i UART</i> <i>Evidenca nr. 16. Mbi numrin e pedagogëve me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme dhe e kualifikimit të tyre.</i> http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=12&niveli=99</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e</p>	<p>Personeli ndihmës akademik ndahet në personel ndihmës akademik me karakter mësimor-artistik/shkencor dhe ndihmës akademik me karakter</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

15

<p>përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>administrativ. Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor artistik/shkencor është pjesë e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit, ku bëjnë pjesë dhe laborantët e teknikët. Personeli ndihmës akademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies, artistike dhe /ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të Universitetit të Arteve në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel institucional. Evidencë. Nr. 11. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Arteve të Bukura Neni nr.17. Evidencë. Nr. 7. Statuti i UART neni nr. 69, 70.</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Departamenti i Skulpturës është organizuar në grupe mësimore. Përgjegjësi i grupit mësimor është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij. Në bazë të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ-ja konstatoi se pranë njësisë kryesore/bazë, përgjegjëse për Programin e studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi” është caktuar një koordinatör i programit të studimit, që është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Evidencë. Nr. 1. Ligji i arsimit të lartë 80/2015 neni nr. 25, pika 5 Evidencë. Nr. 11. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Arteve të Bukura Neni nr.15, 16 Evidencë. Nr. 27. Vendimi i dekanatit të Fakultetit të Arteve të Bukura mbi emrimin e kryetarëve të grupeve mësimore</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>x</p>

<p>Standardi II.3 Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit Masteri Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi” është një program i bazuar në punën praktike (studio/ atelier), i cili mbështetet nga një kornizë teorike si në fushën përkatëse, specifikiisht të skulpturës, por dhe në fushën e mësuesisë. Programi i studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”, nëpërmjet aktiviteteve formuese, teorike dhe praktike, ofron mundësinë për të zgjeruar dhe thelluar kërkimet krijuese të studentit në drejtim të materialit të skulpturës si “gjuhë pamore komunikimi”, por edhe si mesazh komunikimi, nëpërmjet : -Praktikës e projektet individuale. -Praktikës e avancuar e realizimi i projekteve në laborator.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

16

	<p>-Punë teorike, -Praktikë mësimore,</p> <p>Mësimdhënia kryhet nëpërmjet temave specifike, leksioneve teorike, si dhe punëve në laborator, duke ndjekur aktivitete me tema të caktuara, të cilat gërshetohen nëpërmjet punës në atelie, punës në laborator, dhe punës së pavarur.</p> <p>Evidencë. Nr. 13. Rregullore e Prog. Stud. Neni 8 Përmbajtja e programit të studimit</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi” është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me VKM nr. 41, dt. 24.1 2018, udhëzimet e MAS, legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve.</p> <p>Sipas Planit mësimor ngarkesa totale vjetore për 120 ECTS është 3275 orë të shpërndara (brenda dhe jashtë klase), nga të cilat 1710 orë në auditor dhe 1565 orë punë individuale.</p> <p>Kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit përcaktohet në planin mësimor të ndarë në vite të propozuar nga Departamenti i Skulpturës dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit të Arteve të Bukura dhe Senati Akademik në Universitetin e Arteve. Kompetencat dhe objektivat formues të çdo moduli dhe lënde, pjesë e kurrikulës mësimore të programit të studimit, parashikohen në syllabuset respektivë. Veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme nga A në E:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ A. Lëndë bazë; ▪ B. Lëndë karakterizuese; ▪ C. Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese; ▪ D. Lëndë plotësuese; ▪ E. Detyrime përmbyllëse. <p>Veprimtaritë formuese janë:</p> <p>a) të detyrueshme;</p> <p>b) të zgjedhura nga vetë studentët.</p> <p>Orë individuale në auditor ato zënë rreth 525 orë, ndërsa orë individuale pune 575, për një total prej 1100 orësh. Programi përmban 120 kredite, me kohëzgjatje normale dy vite akademike.</p> <p>Evidencë. Nr. 2. VKM Nr. 41, Dt. 24.01.2018, Evidenca. Nr. 21. Plani mësimor dhe ngarkesa mësimore e programit të studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi” http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=660&niveli=73</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Pranimi i kandidatëve në programin e studimit me kohë të plotë Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi” bëhet me konkurs. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p>Kriteret e pranimit të kandidatëve në këtë program përcaktohen nga Departamenti i Skulpturës dhe bëhen publike nga Dekani i Fakultetit të Arteve të Bukura, pasi miratohen nga Senati akademik i Universitetit të Tiranës. Përzgjedhja e studentëve fitues bëhet nga Departamenti i</p>

	<p>Skulpturës dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit të Arteve të Bukura, në bazë të kriterëve të paracaktuara për pranimin në këtë program studimi.</p> <p>Proçeset dhe kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve janë të përcaktuara në dokumentat rregullatorë të Universitetit të Arteve dhe të programit të studimit, në përputhje me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore. Sipas kuotave të miratuara, Universiteti i Arteve mundëson njohjen e krediteve dhe transferimin e studentëve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda programeve që ofron Universiteti i Arteve apo të institucioneve të tjera të arsimit të lartë.</p> <p>Evidencë. Nr. 7. Statuti i UART neni 90, 91 92, 93, 114</p> <p>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e programit të studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”</p> <p>http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=133&niveli=75</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”, përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara referuar VKM 41, dt. 24.01.2018, i ndryshuar. Në planin mësimor të programit të studimit si dhe në secilin syllabus paraqiten informacionet e nevojshme për seminarët apo orët e laboratorit, të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit. Syllabuset rishikohen dhe miratohen përpara fillimit të vitit akademik nga përgjegjësi i departamentit dhe hartohen në përputhje me udhëzimet përkatëse.</p> <p>Gjithashtu programi i studimit, përmban informacionet e nevojshme për praktikat, ku çdo student ka dosjen e tij personale të praktikës, si dhe udhëzuesin e praktikave si dhe syllabusin e saj.</p> <p>Evidencë. Nr. 21. Plani mësimor dhe ngarkesa mësimore për Prog. Stud.</p> <p>Evidencë. Nr. 2. VKM nr.41 datë 24.01.2018 i ndryshuar</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Përmbajtja e Programit të studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”, është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Ashtu siç përmendëm dhe më sipër, ky program lindi si një nevojë për tregun e punës, ku detyrimisht dhe kurrikula e programit u konceptua në mënyrë të atillë që studentit ti ofrohet si njohuri artistike dhe po aq pedagogjike.</p> <p>Përditësimet e programit, vijnë në mënyra të ndryshme, si në bazë të shkëmbimit të eksperiencave gjatë mobilitetet, me kontaktet me artistë vendas e të huaj, apo sugjerimet dhe rekomandimet e ndryshme që vijnë nga pedagogu i lëndës.</p> <p>Në mbledhjet e Departamentit të Skulpturës, si njësi bazë e Fakultetit të Arteve të Bukura, kryhen diskutime rreth mundësive të përmirësimit të programit të studimit. Programet e lëndëve rishikohen çdo fillim viti akademik nga titullari/pedagogu i lëndës, konsultohen midis anëtarëve të departamentit dhe miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit. Në fillim të</p>





	<p>çdo viti akademik miratohen ndryshimet apo përmirësimet e mundshme dhe arkivohet dosja e plotë në gjuhën shqipe.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 2. VKM Nr.185, datë 25.03.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 41 datë 24.01.2018” shkronja c e pikës 2.9</i></p> <p><i>Evidencë. Nr.13. Rregullorja e programit të studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 48. 4 Procesverbal i një mbledhje Departamenti</i></p>			
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Lëndët e programit janë konceptuar që studentët të zhvillojnë aftësi të mëtejshme në fushën e kërkimit artistiko – shkencor, në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe politikave e strategjive kombëtare mbi arsimin. Shpërndarja e lëndëve dhe praktikave është realizuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe akteve nënligjore, që mundëson thellimin e njohurive dhe aftësitë për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve, vecanërisht në fushën e mësuesisë me qasje artistike, gjë që plotësohet me zhvillimin e praktikës në institucione arsimore të shkollave të mesme.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 2. Shtojca 1 e VKM 41 datë 24.01.2018</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 21. Plani mësimor dhe ngarkesa mësimore e programit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”</i></p> <p><i>Evidencë nr. 23 Analizë e Tregut të Punës</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Në programin e studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”, lëndët/ modulet, të shpërndara në vite e semestra, mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor, si dhe gjithashtu programi i mundëson të diplomuarve të vazhdojnë studimet në ciklin e tretë. Organizimi i programit të studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”, është hartuar duke u konsultuar/konsideruar me programe të ngjashme ndërkombëtare si dhe përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës dhe Sistemit Evropian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve [ECTS]. Një kredit përkon me 25 orë punë të studentit, ku përfshihet edhe koha e orëve individuale të studimit. Ngarkesa vjetore e një studenti, që ndjek këtë program studimi është 60 kredite.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al



	<i>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e programit të studimit Master i Arteve në "Skulpturë dhe Mësuesi", neni 2</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	<p>Kurrikula e programit është organizuar në mënyrë të tillë që studenti të ketë një ngarkesë të balancuar përgjatë katër semestrave akademik dhe të sigurojë aftësi profesionale artistike dhe formim mbi fushën e mësuesisë.</p> <p>Struktura e programit është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare, gjë e cila mundësohet dhe nga ndarja e informacionit, shkëmbimi i stafit akademik, traditë prej disa dekadash që institucioni trashëgon, si dhe nga aktivitete të shpeshta që zhvillohen me artistë vendas e të huaj.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 22. Kurrikula 2022 Master i Arteve në "Skulpturë dhe Mësuesi".</i></p>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	<p>Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 5 kategori, nga A - ja deri te E - ja . Në këtë program studimi, ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë transferim të studimeve. Në këtë program studimi, ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë mobilitet të tyre në kuadër të projekteve si Erasmus +.</p> <p><i>Evidenca. Nr. 21. Plani mësimor dhe ngarkesa mësimore në Master i Arteve në "Skulpturë dhe Mësuesi"</i></p> <p><i>Evidencë nr. 23 Analizë e Tregut të Punës</i></p>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	<p>Syllabuset e lëndëve në këtë program studimi janë në përputhje me përcaktimet të VKM 41 datë 24.01.2018 i ndryshuar, i rishikuar ku pasqyrohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● pasqyra informative e lëndës, ● rezultatet e të nxënimit, ● konceptet themelore, ● temat e detajuara të lëndës, ● format e kontrollit të dijeve, ● frekuentimi, ● kontrolli i vazhdueshëm, ● literatura ● vërejtje përfundimtare nga pedagogu <p>Departamenti i Skulpturës, analizon performancën duke u bazuar në ecurinë e programeve të studimeve dhe përfshijnë në to mendimin dhe opinionin e pedagogëve, por edhe të studentëve lidhur me përmbajtjen e lëndëve.</p> <p><i>Evidenca. Nr. 28. Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Master i Arteve në "Skulpturë dhe Mësuesi"</i></p>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master i Arteve në "Skulpturë dhe Mësuesi" garanton dhe është në përputhje të plotë me përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe të shprehura qartë në qëllimet dhe objektivat e secilës lëndë të këtij programi në përputhje dhe në koherencë me objektivat kryesore të programit të studimit.</p>

	<p><i>Evidencë. Nr. 29. Programi i studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e programit të studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 7 Statuti i UART neni 93.</i></p>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e tretë në institucioneve artistike në rajon dhe ato ndërkombëtare.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e programit të studimit.</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 7. Statuti i UART neni 106</i></p> <p><i>Evidencë nr. 23 Analizë e Tregut të Punës</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Pavarësisht se departamenti dhe institucioni synojnë dhe e kanë të përfshirë në planin strategjik të tyre, përmirësimin e mësimdhënies nëpërmjet literaturës të 5 viteve të fundit, GVJ rekomandon mbështetjen e vazhdueshme të blerjes së literaturës dhe përditësimin e saj në funksion të programit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			x	

<p>Standardi II.5 Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Fakulteti i Arteve të Bukura, ashtu si dhe Departamenti i Skulpturës zhvillojnë aktivitete konsultative, me qëllim përshtatjen e programit të studimit me tregun e punës, ku si rrjedhojë pasoi dhe riorganizimi i studimit të ciklit të dytë u në fushën e mësuesisë. Rishikimi i kurrikulës u realizua duke pasur parasysh një sërë kërkesash të tregut artistik, si një nevojë e përfshirjes së akteve ligjore për tregun e punës.</p> <p>Pra në këtë kuadër, Departamenti është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programet e studimit që ai ofron, i cili dhe përzgjedh personelin akademik që angazhohet në mësimdhënie, si edhe garanton shpërndarjen e ngarkesës mësimore. Po ashtu Departamenti është iniciues i procesit të rekrutimit pasi ky proces në përgjithësi nis në përputhje me nevojat për personel akademik, si dhe për ngarkesat mësimore të miratuara. Departamenti është gjithashtu përgjegjës për monitorimin e procesit të mësimdhënies, vlerësimin të stafit, ngjitjen e komisioneve të posaçme për ndjekjen e problematikave, kërkesave për rivlerësime, marrjen e inputeve gjatë mbledhjeve të hapura, rakordimi me sektorë të ndryshëm për përmirësimet e programeve, etj.</p> <p><i>Evidenca nr. 33, Projektet artistike të Prog të studimit.</i></p> <p><i>Evidencë nr. 23 Analizë e Tregut të Punës</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe</p>	<p>Pra, Institucioni dhe konkretisht Fakulteti i Arteve të Bukura, mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar (ALUMNI), duke</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

21


<p>strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>ndjekur ecurinë, punësimin, arritjet etj. Fakulteti i Arteve të Bukura mbledh të dhëna të rëndësishme për punësimin e tyre në bashkëpunim edhe me Sektorin mësimor dhe organizon aktivitete të dedikuara për ALUMNI.</p> <p>Kontaktet mes institucionit dhe ish të diplomuarve janë të vazhdueshme por në kuadër të kohës janë të herë pas hershme. Për këtë arsye propozimet e tyre për përmirësime në programin e studimit janë parë gjithnjë me vlerë dhe të mirëpritura, aty ku është parë e mundshme dhe reale, apo me vlerë për programin dhe studentët pasardhës.</p> <p>Evidencë. Nr. 33. Pjesë nga aktivitetet artistike mes pedagogëve të FAB, studentëve aktualë dhe ish studentëve.</p> <p>http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=705&niveli=71</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit Fakulteti i Arteve të Bukura dhe konkretisht Departamenti i Skulpturës, konfirmon se ky program studimi përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në bazë të nevojave dhe sfidave të reja të tregut artistik. Po ashtu, Departamenti por edhe nga stafi akademik i këtij mbajnë kontakte të vazhdueshme me stafin e mësuesve të arsimit të mesëm të profilizuar si: Liceun Artistik Tiranë, me shkollat e tjera të mesme artistike në vend, por edhe me shkolla të tjera të mesme të përgjithshme në vend, të cilat janë burimi kryesor i Fakultetit të Arteve të Bukura me nxënësit e tyre sot dhe nesër me studentët e këtij fakulteti.</p> <p>Evidencë. Nr. 19. Lista e bashkëpunimeve kombëtare.</p> <p>Evidencë nr. 23 Analizë e Tregut të Punës</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti i Arteve nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">x</p>

<p>Standardi II.6 Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”, i ka përcaktuara prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit artistiko-shkencor në përputhje me objektivat madhorë të UART, ashtu siç vihet re në planin mësimor i cili është konceptuar të ofrojë formim teorik dhe përfitim të njohurive praktike, si në rrafshin artistik, ashtu dhe në fushën e mësuesisë. Prioritetet dhe objektivat kryesore të programit të studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi” janë në përputhje të plotë me objektivat e Departamentit të Skulpturës, Fakultetit të Arteve të Bukura dhe objektivat të Universitetit të Arteve.</p> <p>Evidencë. Nr. 13. Rregullore e programit të studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al





	<i>Evidencë, Nr. 7 Statuti i UART neni 4, 7</i>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Arteve të Bukura, Departamenti i Skulpturës, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë artistike kërkimore shkencore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p> <p>Në vitet e fundit 2019 – 2022 nga Programi i Studimit Skulpturë dhe Mësuesi janë realizuar rreth 50 aktivitete të cilat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ekspozitë Studentore – Ambientet FAB, UART. - Work Shop – Qendra Harabel - Takim studentor në kuadër të praktikës mesimore – Shtypshkronja ALSA - Vizitë kulturore – Galeria Kombëtare e Arteve, Tiranë - Arkivi – Takim në Bibliotekën UART - Takim Virtual – Domosdoshmëria e mësimdhënies online Platforma TEAMS - Takim studentor – Temat studimore dhe doktorale - Ekspozitë Studentore – OPEN AIR – OutDoor Galeria FAB, UART. - Work Shop: Teknikat alternative PRINT MAKING – Laborator Grafika FAB - Work Shop: Vizatimi Digjital – forma të reja teknologjike – Laborator Multimedial FAB - Takim studentor: Print dhe Typografi – Praktika mësimore – Studio Grande Idea Office - Eskursion studentor – Tirana/Qyteti I Vitrinave, Analiza pamore për Dizajnin Grafik - Takim studentor – ArtOn Ekspozitë e Artit bashkëkohor, Qendra STEFANEL - Vizitë kulturore – ONUFRI REMADE, Konkursi ndërkombëtar I artit pamor, Galeria Kombëtare e Kosovës, Prishtinë. - Vizitë kulturore – Ekspozita personale e Prof. Asc. Ardian Isufi: YOU ACT LIKE MORTALS IN ALL THAT YOU FEAR AND LIKE IMMORTALS IN ALL THAT YOU DESIRE – Galeria70, Tiranë - Vizitë kulturore – Ekspozita personale e Prof. Asc. Ardian Isufi: MIRRORS SHOULD THINK LONGER BEFORE THEY REFLECT – Galeria e Artit, Shkodër - Takim Studentor – Teksti Teorik në Arte, Dr. Flutura Haxhillari - Ekspozitë Studentore – PORTOFOLIO GRAFIKA – Galeria FAB, UART - Work Shop: Dizajni Grafik, lektor Harri Aleksi – Dcode packaging NR.1, Lektorium FAB - Work Shop: Dizajni Grafik me Marsel Zara – Dcode packaging NR.2, Lektorium FAB - Work Shop: 2 GULIVERËT me temë PERMOGRAFIA – Lektorium FAB & Qendra Harabel

	<ul style="list-style-type: none"> - Takim studentor me kritikun Italian Giovanni Granzotto – Lektoriumi rrethor UART. - Takim studentor me kuratorin amerikan Raino Isto – ZETA Qendra e Artit Bashkëkohor, Tiranë. - Aplikimet studentore në pjesmarrjen e Bienales Ndërkombëtare të Grafikë, GAT – TIRANA. - Takim Studentor me Street Artistin Grek SAME84 – Atelie Grafika, UART. - Takim Studentor me artistin Ergys Krisiko në ekspozitën personale, COD, Tiranë. - Vizitë studentore në ekspozon graffiti SAME84 “Ne jemi Heronjtë tanë”, Muzeu Historik, Tiranë. - Takim studentor – 8 Dhjetori / DITA E RINISË – Atelie Grafika, UART. - Takim studentor me temë “DIPLOMA PAMORE” analiza studimore, Atelie Grafika, UART. - Vizitë studentore në site arkeologjike për praktikën mësimore, Sarandë - Vizitë kulturore - Ekspozita personale e Prof. Asc. Ardian Isufi: KOMPLOTI I TIRANËS, Galeria Kombëtare e Kosovës, Prishtinë. - Work Shop – DARK CALIGRAPHY me lector Harri Aleks, Atelie Grafika, UART. - Konkurs studentor për ilustrimin “TRUPI IM, E DREJTA IME”, RedCloud, Tiranë. - Pjesëmarrje studentore në SPRING FESTIVAL, Open AIR – Sheshi Skënderbej, Tiranë. - Takim kulturor për artisten Lumturi Blloshmi “KAFKA” – Qendra Harabel, Holli UART - Vizitë studentore në ekspozitën e lektor Petraq Papa “ACTA URBANA”, Galeria FAB - Takim kulturor dhe akademik në ekspozitën studentore ”M.O.S.” të MULTIMEDIAS, Tiranë. - Aksion Studentor në bashkëpunim me Postën Shqiptare “UKRAINA – Post Cards” - Takim Studentor – Historiku i Filatelistë Shqiptare, Galeria e Postës Shqiptare, Tiranë. - Work Shop – ATELIE GRAFIKA në bashkëpunim me Universitetin e New York-ut, UART. - Projekt Virtual Studentor “7 CHAMBERS” – ONLINE ART në bashkëpunim me BALPHIN GROUP, Tiranë - Projekt Grafik Studentor “RAPORTI VJETOR” – broshurë me ilustrime në bashkëpunim me BALPHIN GROUP, Tiranë. <p><i>Evidencë. Nr. 7 Statuti i UART neni 54, 116, 117, 118</i> <i>Evidencë. Nr. 11 .Rregullorja e njësisë kryesore</i> <i>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e programit të studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”.</i></p>
--	---

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Evidenca nr. 33, Projektet artistike të Prog të studimit</p> <p>Programi i studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi” , nxit dhe motivon studentët të përfshihen në studime dhe projekte apo aktivitete artistike. Kjo realizohet nëpërmjet punimit të diplomës, I cili është san ë rrafshin artistik, e po aq dhe teorik. Gjatë procesit të saj, studentët janë jo vetëm në kontakt të vazhdueshëm me pedagogun udhëheqës, por dhe zhvillojnë kërkim në terren, intervista apo hulumtime të literaturës, raste studimore, të cilat ndikojnë pozitivisht në analizën teorike.</p> <p>Gjithashtu, stafi, departamenti i nxisin studentët të marrin pjesë në biseda, ëorkshop-e, aktivitete artistike që kanë të bëjnë jo vetëm me përhapjen e ideve artistike por edhe me sfidat e tregut të punësimit dhe nxitjen e aftësive personale. Një vlerë e shtuar është dhe pjesëmarrja në mjaft ekspozita të përbashkëta, kolektive, individuale, dhe aktivitete të ndryshme që zhvillon fakulteti.</p> <p>Evidencë. Nr.7. Statuti i UART neni 123</p> <p>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e programit të studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi” neni 34 Punimi teorik dhe praktik i diplomës</p>			
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Universiteti i Arteve në përputhje me misionin e tij të mësimdhënies, në fushën e artit dhe kulturës e të kërkimit artistiko - shkencor, përcakton në buxhetin e tij një fond për çdo njësi bazë sipas planifikimit të argumentuar.</p> <p>Institucioni i mbështet njësitë bazë të bazë të përfitimeve që arrihen nga programet e projektet që zhvillohen në rrafsh kombëtar dhe ndërkombëtar për financimin e aktiviteteve artistike, të kërkimit artistik/shkencor dhe teknologjik, si dhe gjithashtu në bazë të organizimit të mobiliteteve të stafit dhe organizimit të ekspozitave që organizohen pranë Galerisë FAB, pjesë e insitucionit.</p> <p>Evidencë. Nr. 7. Statuti i UART neni 7, 117, 139, 140, 141, 142 144</p> <p>Evidencë. Nr. 30. Model aplikimi të një projekti</p> <p>Evidencë. Nr.41. Të dhëna financiare nga Drejtoria ekonomike për tre vitet e fundit për fondet e planifikuara për Dep e Skulpturës.</p> <p>http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=965&niveli=138</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor. Pavaresisht kësaj, GVJ rekomandon mbështetjen financiare të stafit nga strukturat përkatëse në hapjen e ekspozitave personale apo kolektive jashtë vendit, si dhe në mbështetjen e tyre në botimin e studimeve apo pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare, aspekte këto, që do të ndikonin pozitivisht në përmirësimin e ecurinë e programit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			x	

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Sa i përket veprimtarisë artistike-kërkimore në Fakultetin e Arteve të Bukura realizohet, në të tre njësitë bazë/departamentet e tij përmes grupeve kërkimore që funksionojnë pranë këtyre njërive.</p> <p>Pra, grupi mësimor është përgjegjës për grup-lëndët përkatëse që ofron programi i studimit dhe harton përmbajtjen e tyre dhe të programeve lëndore përkatëse në përputhje me kërkesat e kohës dhe të ekonomisë në vend. Po ashtu ai është përgjegjës për përditësimin në vazhdim të tyre dhe për mbulimin e tyre me staf të kualifikuar të brendshëm ose të jashtëm.</p> <p>Secili grup pune është përgjegjës për saktësimin, zgjerimin dhe thellimin e materialeve të nevojshme për procesin artistiko-kërkimor-shkencore, dhe për kualifikimin në vazhdimësi të tyre.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 11. Rregullorja e Njesise Kryesore</i> <i>Evidencë. Nr. 7. Statuti i UART.Neni 17 pika 1,2,3,4 neni 119 pika 4</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Sa i përket Departamentit të Skulpturës, bashkëpunon ngushtësisht me departamentet e tjera të Fakultetit të Arteve të Bukura si dhe me institucione arsimore, kulturore e shkencore të vendit ku disa nga punonjësit e këtyre institucioneve janë edhe pedagogë të ftuar në Departamentin e Skulpturës për realizimin e projekteve artistike-kërkimore-shkencore.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 18. Marrëveshje bashkëpunimi të lidhura mss UART dhe institucioneve artistike, arsimore dhe kërkimore shkencore.</i> <i>Evidencë. Nr. 33. Materiale që tregojnë bashkëpunimin e Departamentit të Skulpturës me departamente të tjera të Fakultetit të Arteve të Bukura dhe jo vetëm.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Aktivitetet përmes projekteve artistike dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit që Universiteti i Arteve që ka me institucione të tjera artistike në kombëtare dhe ndërkombëtare, mundëson organizimin e aktiviteteve artistike dhe shkencore, me qëllim rritjen profesionale të stafit, dhe arritjen e objektivave mësimore për studentët.</p> <p>Hapësira e Galerisë FAB ku ky rezultat gjen vend ekspozimi është aktualisht galeria më dinamike në rang kombëtar me mbi 25 aktivitete në vit, dhe mbi 30 mijë vizitorë.</p> <p>Poashtu, në rang programi vetëm në vitin 2021-2022 janë realizuar mbi 30 aktivitete mes ekspozitash, takimesh, workshopesh, vizitash, aplikimesh etj.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 8. VKM nr. 145 date 10.03.2021 Mbi satatusin e veçantë të UART</i> <i>Evidencë. Nr. 31. Marrëveshje bashkëpunimi midis UART dhe institucioneve artistike apo mësimore dhe kërkimi shkencor</i> <i>Evidencë Nr. 32. Projekte/postera veprimtarish artistike</i> http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=17&niveli=85</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”, për t’u përafruar sa më shumë me tregun e punës, programet e studimit të ciklit të dytë u riorganizuan të gjitha në programe studimi në fushën e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al

për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	<p>mësuesisë, ku studenti merr njohuri të thelluara në fushën e mësuesisë në specialitetin përkatës, konkretisht në artin e Skulpturës, me synimin e formimit artistik por jo vetëm. Pjesë e kësaj reforme ishte edhe përfshirja e diplomave që lëshon Institucioni jonë në profesionet e rregulluara (mësuesi), tashmë si një nevojë e përfshirjes së akteve ligjore për tregun e punës.</p> <p>Evidencë. Nr.. 7. Statuti i UART Neni 4 Evidencë. Nr. 29. Programi i studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	Ky kriter nuk aplikohet nga Institucioni.			
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”, është ndërtuar mbi legjislationin në fuqi dhe bën pjesë në profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë. Ky program studimi përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaston se programi i studimit ofron njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor. Pavarësisht kësaj, në bazë të vizitës në institucion, e të diskutimeve me studentët e këtij profili, u ngrit si diskutim krijimi i njësive kërkimore aplikative.</i></p> <p><i>Ngritja e një njësie të tillë do të ndihmonte akoma më shumë studentët dhe stafin në zhvillimin e kërkimeve dhe teknologjive të reja.</i></p> <p><i>Ngritja e një laborator i cili do të ishte i pajisur me printer 3D dhe të cilët do të shërbenin studentët për printim të boceteve e formave në mënyrë që të imitohen me saktësi nga ta në Skulpturë. Pra, ky laborator i ndihmon studentët të transformojnë idetë e tyre në prototip përmes eksperimentimit e printimit në 3D,</i></p> <p><i>Kjo njësi e kërkimit aplikativ mund të angazhohet dhe botimin e punës kërkimore të Universitetit në periodikë të caktuar që ndiqen nga departamenti përkatës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Pra, referuar Rregullores së Programit të Studimit si dhe planit mësimor, format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve janë shtjelluar si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Leksion; • Seminari; • Projekti artistik është mund të jetë një vepër arti, një tekst teorik hulumtues i një koncepti, periudhe të historisë së artit, rrymë artistike ose një artisti, i cili mund të finalizohet me një ekspozitë/sfilatë ose me prezantim në fund semestër/ viti. Ky projekt konsultohet nga studenti hap pas hapi me pedagogun duke filluar me dhënien e informacionit nga ky i fundit me anë të një leksioni apo trajnimit; • Kolokiumi është një formë e vlerësimit të njohurive të studentëve, e cila jepet me shkrim ose me gojë; • Puna individuale është vlerësimi i punës së bërë individualisht; • Detyrat praktike; <p>Vlerësimi: Provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare janë format kryesore të vlerësimit të studentëve</p> <p>Lidhja me tregun: Praktika që materializon dhe konkretizon, njohuritë e marra gjatë studimeve dhe njohjen e studentëve me tregun e punës; Teza/Diplomimi është detyrimi përfundimtar i studentit për të marrë një diplomë në fund të studimit të programit MA në “Skulpturë dhe Mësuesi”. Gjithashtu një rol luajnë dhe workshopet e leksionet e hapura me pedagogë të ftuar, vendas dhe të huaj.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 8. VKM-së Nr. 145, datë 10.03.2021,</i> <i>Evidencë. Nr. 7. Statuti i UART</i> <i>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e programit të studimit</i> <i>Evidencë. Nr. 28. Syllabuset e lëndëve të programit të studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e</p>	<p>Vlen të ceket se personeli akademik është përgjegjës për zhvillimin e procesit mësimor dhe realizimin e kontrollit të dijeve për lëndët individuale, grupet mësimore të studentëve që i përcaktohen në çdo fillim viti akademik nga titullari i lëndës. Po ashtu, personeli akademik</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

28

<p>mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>i përfshirë në këtë program studimi udhëzohet dhe nxitet nga departamenti që të orientojë dhe informojë studentët mbi disa elementë përgjatë procesit mësimor siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ pritshmëritë e tyre për programin dhe lëndën përkatëse; ✓ njohuritë e tyre paraprake për çështjet më të rëndësishme që trajton lënda përkatëse; ✓ mënyrën se si ata e vlerësojnë lidhjen e lëndës përkatëse me lëndë të tjera të programit mësimor; ✓ Rëndësisë që ka lënda përkatëse për formimin e tyre si mësues në fushën e artit dhe të edukimit; <p>Evidencë. Nr. 7. Statuti i UART neni 63, 68 Evidencë. Nr. 11. Rregullore e Fakultetit të Arteve të Bukura Evidencë. Nr. 12. Rregullore e ciklit të dytë të studimeve</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.</p>	<p>Duke parë cilësinë si primare dhe në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies përmes rritjes së kapaciteteve të stafit akademik, institucioni, drejtuesi i departamentit dhe vetë anëtarët e departamentit nxisin pjesëmarrjen në trajnime, masterclass-e dhe aktivitete të tjera artistike të cilat kanë në fokus pikërisht cilësinë e mësimdhënies, përmes njohjes së metodave të reja të mësimdhënies, mënyrave të ndryshme të vlerësimit, etj. Mësimdhënia mbështetet në disa metoda të rëndësishme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>Mësimi frontal: transmetimi i koncepteve teroike dhe artistike</i> ▪ <i>Demonstrimi: bazohet në parimin e imitimit dhe pedagogu ofron demonstrimin praktik se si përdoret një teknikë e caktuar</i> ▪ <i>Qasja tutoriale: verifikimi i menjëhershëm i nxënies së dijeve, me pyetje të synuara për studentët.</i> ▪ <i>Diskutim: konsiston në një krahasim të punimeve, projekteve ndërmjet pedagogut dhe studentëve dhe ndërmjet studentëve. Kjo metodë përmes një procesi dialektik, pikërisht dialogut.</i> ▪ <i>Rast studimor: si një strategji metodologjike e bazuar në reflektime në lidhje me një teknikë apo temë të caktuar.</i> ▪ <i>Puna në grup: që optimizon bashkëpunimin dhe mbështetjen e ndërsjellë midis studentëve</i> ▪ <i>Projekti: bazohet në një integrim teknikash, e mbi një temë të caktuar.</i> ▪ <i>Brainstorming: nxit të mësuarin duke i dhënë pavarësi studentit, në lidhje me një temë specifike.</i> ▪ <i>Puna laboratorike: Puna laboratorike favorizon të mësuarin praktik dhe dialogun, si dhe reflektimin mbi punën, duke favorizuar mundësitë që studentët të ndërtojnë në mënyrë aktive njohuritë e tyre. Mësimdhënia laboratorike inkurajon një qëndrim aktiv të studentëve ndaj njohurive të përfutuara teorikisht. Ky mësim bazohet në nevojat e nxënësit individual; promovon të nxënësit në bashkëpunim; mundëson zhvillimin e aftësive.</i> <p>Gjithashtu, krahas kësaj metodologjie, fokusi i institucionit është në nxitjen dhe trajnimin e stafit dhe në integrimin e metodave</p>

	<p>bashkekohore, të cilat përkthehen në mësimdhënie dhe si praktika të mira që të integrohen në proceset mësimore. Programet Erasmus, Erasmus+ shërbejnë për të shkëmbyer eksperiencë dhe për t'u njohur me zhvillimet e rëndësishme ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies dhe të nxënit. Rast konkret ka qënë vizita më e fundit e stafit të FAB, në Programin Erasmus Plus, në Sevilje të Spanjës.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 7. Statuti i UART neni, 68</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 11. Rregullore e Fakultetit të Arteve të Bukura</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 12. Rregullore e ciklit të dytë të studimeve</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 17. Të dhëna të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në projektet Erasmus, Erasmus+</i></p> <p>http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=686&niveli=72</p> <p>http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=785&niveli=126</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Sa i përket Personelit akademik që është i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”, përveç titujve dhe gradave shkencore ka edhe eksperiencia dhe kualifikime të rëndësishme të krijuara nga takime ose aktivitete të rëndësishme artistike kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Në bazë të dokumentacionit, dhe vizitës në institucion, GVJ-ja konstatoi se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. Këtë gjë e tregon dhe e dëshmon përzgjedhja e tyre sipas fushave, si dhe eksperiencia e tyre në fushat përkatëse. Këtë e dëshmojnë gjithashtu dhe cv-të e stafitë pedagogjik që janë personalitete në fushat e tyre përkatëse, si dhe komunikimi që komisioni vlerësues pati me studentë, pati një feed-back pozitiv në lidhje me mësimdhënien, dhe marrëdhien dialoguese, mbështetëse dhe profesionale pedagog-student. Përgjatë vizitës në institucion, u konstatua dhe gjatë bisedave me studentët.</p> <p>Sipas dokumentacionit të paraqitur, në tri vitet e fundit, Fakulteti i Arteve të Bukura, Departamenti i Skulpturës, ka angazhuar në këtë program studimi mesatarisht një staf me kohë të plotë që mbulon 90% të ngarkesës mësimore.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 35. Të dhëna të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik.</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 36. Të dhëna mbi titujt akademik dhe gradave shkencor të stafit akademik të programit të studimit dhe CV të personelit akademik të angazhuar në këtë program</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 21. Plani mësimor dhe të dhëna të mbulimit të ngarkesës së programit në tre vitet e fundit nga një përqindje mbi 70% nga stafi akademik i brendshëm.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në</p>	<p>Strukturat kryesore për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në Universitetin e Arteve, janë njësitë bazë. Njësia bazë, shqyrton raportimin e problematikave të hasura dhe ecurinë e mësimdhënies për çdo pedagog, duke bërë analizën mësimore, në funksion të mbështetjes dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Analiza e procesit</p>

<p>këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>mësimor bëhet në përfundim të vitit akademik. Për të bërë këtë analizë, Departamenti i Skulpturës mbështetet në sugjerimet dhe komentet e stafit mësimdhënës, në anketimet e studentëve, si dhe në të dhëna që gjenerohen nga sekretariatë mësimore.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit MA në “Skulpturë dhe Mësuesi”, në përfundim të procesit mësimor shprehet për problematikat që ka hasur dhe mund të propozojë ndryshime në elementë të programit të lëndës, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të saj.</p> <p>Departamenti i Skulpturës analizon të gjitha elementët e realizimit të procesit mësimor, si mbulimi me materiale studimore, realizimi i formave të kontrollit të vazhdueshëm dhe provimit përfundimtar të lëndëve, realizimi i praktikave profesionale, realizimi i punimeve të diplomave, dhe bën propozimet përkatëse për ndryshime, nëse e vlerëson të arsyeshme.</p> <p>Përmirësimi të cilësisë së mësimdhënies i shërben edhe mbikëqyrja e standardeve të përgatitjes së planeve mësimore, syllabuseve të lëndëve si dhe gjithë dokumentacionit të programeve të studimit.</p> <p>Gjithashtu, personeli akademik asistohet nga personel ndihmës akademik dhe nga personel administrativ, të cilët angazhohen në ndihmë të procesit mësimor nëpërmjet elementëve të tillë si zhvillimi i punëve të laboratorit në përputhje me programin e studimit, ndjekja e zhvillimit të praktikave mësimore, mirëmbajtja e bazës laboratorike, ndihmesa në zhvillimin e praktikave të diplomave etj.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 15 Raporti vjetor i punës artistike mësimore-shkencore i stafit akademik të UART për vitin akademik 2019-2020).</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 12. 3 VSA Nr. 5 për Miratimin e raportit vjetor të UART për vitin akademik 2019-2020</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 38. Të dhëna nga pyetësi i studentëve</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Strukturat kryesore për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në Universitetin e Arteve, janë njësitë bazë. Njësitë bazë/Departamentet mbështeten në strukturat përkatëse si Sektori mësimor, i Kurrikulave dhe Informimit të studentëve si dhe Sekretariatë mësimore pranë secilit Fakultet, duke koordinuar punën për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Institucioni ndjek politika mbështetëse për kualifikimin e personelit akademik për të kontribuar në këtë mënyrë në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Kjo politikë, konsiston edhe në mbështetjen e mobilitetit të personelit akademik, me qëllim përfundimin e eksperiencave dhe metodologjive të reja të mësimdhënies.</p> <p>Organizimi i veprimtarive të përbashkëta artistike me studentë e pedagogë, bashkëveprimi midis tyre në këto veprimtari si dhe bashkëveprimi me departamente të tjera, është një nga format e veçanta dhe inovative të mësimdhënies në Departamentin e Skulpturës.</p> <p>Cilësia e mësimdhënies lidhet ngushtë me formimin artistik të pedagogëve, të cilat janë pasqyruar në artikuj e botime të tjera shkencore, ëorkshope dhe konferenca artistike-kërkimore-shkencore.</p>

	<p>Një aspekt i rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies është trainimi i stafit akademik në fushën e cilësisë së edukimit.</p> <p>Departamenti është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programet e studimit që ai ofron, i cili dhe përzgjedh personelin akademik që angazhohet në mësimdhënie, si edhe garanton shpërndarjen e ngarkesës mësimore. Departamenti është iniciues i procesit të rekrutimit pasi ky process në përgjithësi nis në përputhje me nevojat për personel akademik. Departamenti harton syllabuset, kalendaret, caktimin e pedagogut përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të praktikave profesionale, shpërndan e mbledh formularët aplikimin dhe vlerësimin, miraton institucionet e praktikave, etj. Departamenti është gjithashtu përgjegjës për monitorimin e procesit të mësimdhënies, vlerësimin të stafit, ngritjen e komisioneve të posaçme për ndjekjen e problematikave, kërkesave për rivlerësime, marrjen e inputeve gjatë mbledhjeve të hapura, rakordimi me sektorët për përmirësimet të mëtejshme, etj. Departamentet hartojnë në mënyrë periodike raporte dhe vlerësime.</p> <p>Evidencë. Nr. 7. Statuti i UART, Neni nr.37 Evidencë. Nr. 39. Të dhëna mbi mobilitetin e pedagogëve të Fakultetit të Arteve të Bukura</p>			
Konkluzione	<p><i>Sipas dokumentacionit të paraqitur, në tri vitet e fundit, Fakulteti i Arteve të Bukura, Departamenti i Skulpturës, ka angazhuar në këtë program studimi mesatarisht një staf me kohë të plotë që mbulon 90% të ngarkesës mësimore.</i></p> <p><i>Në bazë të raportit të paraqitur, të gjithë pedagogët me kohë të plotë kanë marrë përsipër realizimin e mbinormës mësimore në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë. GVJ rekomandon shtimin e stafit akademik, në mënyrë që stafi akademik aktual të ketë mundësinë për tju dedikuar kërkimit shkencor dhe atij aplikativ.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimin të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimin të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme,	<p>Në këtë program studimi, ashtu si edhe në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë që ofrohen në Universitetin e Arteve, për të vlerësuar njohuritë e studentit përdoret sistemi i vlerësimin me 10 nota (nga 1 tek 10, ku 10 është vlerësimi maksimal).</p> <p>Disa nga format e organizimit të provimit në Fakultetin e Arteve të Bukura janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Provimi i lëndëve speciale

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

32


<p>bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 2. Provimi me shkrim në klasë brenda një afati kohor të caktuar; 3. Provimi me shkrim e me gojë, ku provimi me shkrim është parakusht për të hyrë me gojë. 4. Provimi në grup në realizimin e veprave artistike sipas programit të miratuar. <p>Forma e vlerësimit shprehet në planin mësimor të lëndës; mënyra e organizimit të provimit dhe pesha që zë çdo element në vlerësimin përfundimtar shprehen në programin e lëndës dhe i bëhen të ditur studentit që në fillim të semestrit.</p> <p>Të gjitha rregulloret janë të publikuara online në faqen e ëeb-it të universitetit të arteve.</p> <p>Evidencë. Nr.. 11. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Arteve të Bukura Evidencë. Nr. 11. 1 VSA Nr. 37 datë 21.12.2021 Evidencë. Nr.. 12.1. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Skulpturës Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e programit të studimit</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Programi i studimit është i publikuar në faqen zyrtare www.uart.edu.al. Gjithashtu studentët në fillim të secilit semestër njihen me të gjithë syllabuset e lëndëve, ku jepen në detaje temat e lëndës, literatura kryesore, forma e kontrollit të dijeve, literatura e rekomanduar. Një kopje elektronike e programit publikohet në faqen e web-it, në të cilën shfaqen lëndët, semestrat, shpërndarja e krediteve si dhe lëndët me zgjedhje. Gjithashtu dhe stafik akademik, i ofron studentëve informacione mbi programin, lëndët, detyrimet akademike, vlerësimin, praktikën si dhe diplomimin. Forma e vlerësimit shprehet në planin mësimor të lëndës; mënyra e organizimit të provimit dhe pesha që zë çdo element në vlerësimin përfundimtar shprehen në programin e lëndës dhe i bëhen të ditur studentit që në fillim të semestrit. Në syllabusin e lëndës/modulit shprehen modalitetet e vlerësimit të saj.</p> <p>Evidencë. Nr. 12.1 .Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Skulpturës Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e programit të studimit Evidencë. Nr. 21. Plani mësimor Evidencë. Nr. 29. Programi i lëndës Evidencë. Nr.. 28. Syllabus i lëndës</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Referuar Rregullore së programit të studimit, Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”, format kryesore të procesit mësimor janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Format e mësimit teorik e praktik: mësimet artistike, profesionale individuale dhe kolektive, leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat profesionale, projektet artistike individuale dhe kolektive, konsultimet, etj. b. Format e kontrollit të dijeve: bashkëbisedimet, kontrollet teknike, mbrojtje e detyrave e projekteve individuale dhe të kursit, mbrojtje e praktikave profesionale, provime të ndërmjetme, provimet e

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

33



	<p>kursit, provimet e formimit, mbrojtje e temave e diplomave, aktivitetet artistike (Ekspozita tematike), etj.</p> <p>Kontrolli i dijes bëhet nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> Provimit me shkrim. Provimit me gojë. Vlerësimin të detyrave dhe të projekteve. Kombinimi i tre formave të sipërme: me shkrim, me gojë dhe me projekt. Provimi i formimit artistik (lëndë të formimit special) konsiston në vlerësim të realizimit artistik profesional dhe teknik të programit. Provimi në grup dhe individual. <p><i>Evidencë. Nr. 12.1 .Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Skulpturës</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 21. Plani mësimor</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 29 . Programi i lëndës</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 28. Syllabus i lëndës</i></p>			
Konkluzione	<p>GVJ konstatoi se institucioni ka hartuar rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimin të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x

Standardi III.3


Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Vlerësimi i studentit kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe gjatë gjithë vijimësisë së ndjekjes së programit të studimit.</p> <p>Në programin e lëndës është përcaktuar qartë edhe mënyra e vlerësimin, pesha e secilit komponent dhe shpërndarjen e pikëve.</p> <p>Format e testimit të studentëve është e shprehur si më poshtë kanë këtë peshë:</p> <p>Pjesëmarrje aktive në orën e mësimin: 10%</p> <p>Puna e pavarur krijuese: 20%</p> <p>Detyrat e kursit: 20%</p> <p>Projektet e kursit: 20%</p> <p>Provimi përfundimtar: 30%</p> <p>Provimet në Fakultetin e Arteve të Bukura, zhvillohen brenda periudhave të përcaktuara në strukturën mësimore të vitit Akademik.</p> <p>Provimet, zhvillohen në tre sezone.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 12.1 .Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Skulpturës</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423


Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




	<p><i>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidenca. 28. Tip syllabusi i lëndës</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Sa i përket mënyrës së organizimit të testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, zbatohet sistemi i provime të cilat zhvillohen në auditor.</p> <p>Gjatë kohës së pandemisë institucioni mori masa për organizimin e mësimit dhe kontroleve online, nëpërmjet sistemit Microsoft Teams, zbatuar dhe të administruar nga Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit. Studentët i mbrojtën provimet online, me mënyra alternative, individualisht apo me grupe të vogla të organizuara në bashkëpunim dhe nën drejtimin e stafit akademik.</p> <p>http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=963&niveli=68</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga titullari i lëndës/modulit si dhe nga një pedagog tjetër përgjegjës. Praktika profesionale dhe diplomimi, që janë dhe detyrimet përmbyllëse, realizohen nga komisione të ngritura në mënyrë të posaçme, duke ndjekur përcaktimet në Rregulloren e programit të studimit MA në Skulpturë dhe Mësuesi. Universiteti i Arteve, në Rregulloren e studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë Master, por edhe në Rregulloren e programit të studimit Mastër i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”, ka të përcaktuar qartësisht sa më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● sistemin e vlerësimit; ● format e kontrollit; ● sezonet e provimeve; ● provimi dhe kontrolli i dijes; ● dokumenti i vlerësimit të studentëve; ● Kushtet e kalimit në vitin pasardhës si dhe përmirësimi i notës. <p>Në syllabus paraqiten format e vlerësimit të lëndës, mënyra e organizimit të provimit dhe pesha që zë çdo element në vlerësimin përfundimtar e paraqitur në orë dhe në kredite. Syllabusi i bëhet të ditur studentit që në fillim të semestrit. Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, që përkthehen në notë. Tezat e provimit për lëndët teorike, në të gjitha rastet e kontrollit, hartohen nga titullari/ët i/e lëndës dhe miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e programit të studimit Master i Arteve në “ Skulpturë dhe Mësuesi”</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 12. Rregullorja mësimore e ciklit të dytë të studimeve Master.</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 21. Plani mësimor dhe ngarkesa mësimore e ciklit të dytë Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 29. Programi i lëndëve për programin e studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”</i></p>

<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Aftësimi teorik dhe praktik i studentëve kontrollohet përmes vlerësimit të vazhduar gjatë vitit për elementet e përcaktuar në programin e modulit dhe vlerësimit përfundimtar në provimet e çdo fund-viti, në provimin e praktikës profesionale si dhe në mbrojtjen e diplomave apo provimit të formimit. Konsultat e vazhdueshme janë një metodologji pune e këtij program, për vetë nyrën e metodikën sesi lëndët zhvillohen.</p> <p>Në përfundim të çdo semestri, çdo pedagog kryen analizën e punës së atelierit, analizë që më pas bëhet në rang departamenti dhe më pas në rang fakulteti.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 12.1. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Skulpturës</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në lidhje me kryerjen e provimeve, institucioni i ka të përcaktuara në rregullore të gjitha hapat e procedurat konkrete të zhvillimit të provimeve. Në vëzhgimin e ecurisë së provimit, anagazhohen stafi e personali i paracaktuar, në mënyrë që provimet të zhvillohen në mënyrë sa më korrekte.</p> <p>Verifikimi i cilësisë së punimeve shkencore është realizuar përmes platformës anti-plagjiaturë të vënë në dispozicion nga RASH dhe të administruar nga Sektori i TI sipas udhëzimeve të Këshillit të Etikës së Institucionit.</p> <p>http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=98&niveli=104</p> <p><i>Evidencë. Nr. 12.1 .Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Skulpturës</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. Rezultatet hidhen edhe në Sistemin elektronik, ku studenti i pasqyrohet të gjitha vlerësimet sipas komponentëve përkatës.</p> <p>Në UART nga 2021, përdoret sistemi PITAGORA për menaxhimin e studimeve dhe të kurrikulës në shërbim të marrëdhënies Pedagog - Student – Institucion. Ky sistem është mundësuar nga Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH) dhe administrohet nga Sektori i TI në bashkëpunim me RASH, si edhe në koordinim me Sekretariatë Mësimore në Fakultete dhe strukturat përkatëse në Rektorat. Ky sistem që përmban të dhënat që hidhen nga Sekretariatë Mësimore në Fakultete kryen funksione administrative, administrim të didaktikës: ofertës akademike/ karrierës së studentit/ provimeve dhe notave, administrim të studentëve hyrës dhe dalës, shërbime të tjera, etj.</p> <p>Sistemi përdoret nga pedagogët për pasqyrimin e rezultateve dhe përpilimin e procesverbaleve, përdoret nga studentët për informimin e tyre lidhur me aktivitetin akademik në Universitet (kalendarët, provimet, notat, njoftimet, etj.), si dhe përdoret nga personeli administrativ në Rektorat për përpunim të dhënash statistikore.</p>



	http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=585&niveli=67 Evidencë. Nr. 12.1 .Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Skulpturës Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e programit të studimit. Evidencë Nr. 46. Manuali TI			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	<p>Në të gjitha format e organizimit të provimit, studenti merr vlerësimin përkatës nga komisioni jo më vonë se tre deri në pesë ditë pune nga data e dhënies së provimit. Në raste të jashtëzakonshme shtyrja e dhënies së rezultatit bëhet me vendim të Dekanit. Komisioni shpall rezultatet e vlerësimit, para plotësimit të dokumentacionit përkatës. Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij, ose të kontestojë rezultatin e marrë. Komisioni i vlerësimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuar apo regjistrimet (kur ka) të studentit me tezën e zgjidhur. Në rastet e kontestimit të rezultatit, në komision duhet të marrë pjesë edhe përgjegjësi i Departamentit të Skulpturës, për të monitoruar transparencën e procesit. Në përfundim të këtij procesi rishikimi, komisioni merr vendimin përfundimtar, i cili është i formës së prerë. Kontestimi i rezultatit nga ana e studentit bëhet me shkrim brenda 24 orëve nga shpallja e rezultatit.</p> <p>Evidencë. Nr. 12.1. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Skulpturës Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e programit të studimit</p>			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	<p>Studenti ka të drejtë të ankohe, në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose është bërë vlerësim i pamërituar. Ankesa depozitohet me shkrim brenda një afati prej 24 orësh nga shpallja e rezultatit në Dekanat, e cila shqyrtohet nga Dekani. Pas gjykimit të çështjes, merr vendimin përkatës të formës së prerë brenda 3 (tre) ditëve. Vendimi i Dekanit përcakton nëse kërkesa e studentit është e drejtë ose jo. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studentit është ankuar dhe vendos që studentit të jap përsëri provimin, me të njëjtin komision ose me një komision të ri dhe nën monitorimin e një përfaqësuesi të caktuar nga Dekani, në një datë tjetër brenda sezonit ose jashtë tij, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve.</p> <p>Evidencë. Nr. 12. 1. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Skulpturës Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e programit të studimit</p>			
Konkluzione	<i>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Standardi III.4 Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programet e studimit të Ciklit të Dytë, Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi” japin njohuri të thelluara artistike, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim të pavarur artistik kërkimor shkencor në fushën e specialitetit të Skulpturës. Në përfundim të studimeve në këtë cikël studimi, lëshohet diplomë “Master i Arteve”. Programi synon një edukim profesional, bashkëkohor jo vetëm në fushën e artit pamor por gjithashtu ofron një përgatitje tërësore, profesionale në fushën e mësuesisë, me formim sa artistik, e po aq teorik. <i>Evidencë. Nr. 12.1 Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Skulpturës</i> <i>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e programit të studimit</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi” ofrohet në gjuhën shqipe. Sipas planit mësimor të këtij programi studimi, në kategorinë e lëndëve me zgjedhje ofrohet edhe lënda Njohuri Kompjuteri 3D, e cila ngelet në dëshirën e studentit nëse zgjidhet prej tij ose jo. Këto lëndë garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta nëpërmjet pajisjeve kompjuterike e periferike dhe realizimin si dhe nëpërmjet printit me të gjitha parametrat që kjo fushë kërkon. <i>Evidenca. 11. Rregullore Mësimore FAB, Kreu V, pika 6</i> <i>Evidenca. 12.1. Rregullore Departamentit të Skulpturës</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblyëse.	Kompetencat, aftësimi teorik dhe praktik i studentëve kontrollohet përmes vlerësimit të vazhduar gjatë vitit për elementet e përcaktuar në programin e modulit dhe vlerësimit përfundimtar në provimet e çdo fund-viti, në provimin e praktikës profesionale si dhe në mbrojtjen e diplomave apo provimit të formimit. Realizimi i programit do të mbështetet në një strategji që ndahet në tre faza kryesore: 1- Tema në Projekte dhe Detyra 2- Praktikë e avancuar 3- Punë teorike, e cila mbështet dhe eksploron fushën ku ngrihet projekti, dhe finalizohet me një studim shkencor dhe kritik. <i>Evidencë. Nr.15. Raporti vjetor i punës artistike mësimore-shkencore i stafit akademik të UART për vitin akademik 2019-2020.</i> <i>Evidencë. Nr. 12.1. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Skulpturës</i> <i>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e programit të studimit</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë	Një ndër elementët e rëndësishëm dhe specifik të procesit mësimor në këtë program studimi është puna në grupe të ndryshme e studentëve të

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




<p>studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuar kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>cilët bashkëveprojnë me njëri tjetrin jo vetëm me studentët e këtij programi por edhe me studentët e programeve apo departamenteve të tjera, brenda institucionit apo dhe në institucione të tjera artistike kulturore.</p> <p>Cilësia akademike garantohet dhe përmes angazhimit, të stafit që me gradat përkatëse shkencore por edhe me personalitete apo ekspertë në fusha të caktuara të arteve pamore. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin trajtimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, të cilat stafi akademik i përfton dhe gjatë shkëmbimit të ideve e eksperiencave të ndryshme, brenda dhe jashtë institucionit. Kjo vjen natyrshëm, dhe për vetë natyrën metodologjike që kanë fushat e artit në përgjithësi, ku lind, dhe është domosdoshmëri, zhvillimi i performancës individuale, dhe bashkëpunimi në grup. Kjo gjë bazohet në planin strategjik të Departamentit të Skulpturës, i cili synon, të mbështesë si studentët në avancimin e njohurive të tyre, gjithashtu dhe në mbështetjen e stafit akademik, ku puna, dhe pasurimi i aktiviteteve të tyre, rrjedhimisht reflektohet më pas dhe në mësimdhënie.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 12.1. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Skulpturës Nenet 39, 40</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 13. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 40 Të dhëna mbi mobilitetin e studentëve për programin e studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik efektiv dhe me kontratë në Fakultetin e Arteve të Bukura organizon në mënyrë të vazhdueshme Ekspozita, të stafit pedagogjik, studentëve të njërit apo shumë programeve studimore, brenda dhe jashtë institucionit, workshope, leksione të hapura me të ftuar nga brenda apo jashtë institucionit, në bashkëpunim me personalitete dhe institucione, vendas apo të huaj. Në Fakultetin e Arteve të Bukura janë realizuar mesatarisht çdo vit 25 - 30 aktiviteve artistike, mes ekspozitash, workshope e leksione të hapura, ku Galeria FAB, mbetet një nga hapësirat më aktive në kryeqytet.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 32. Fletëpalosje me kalendarin e aktiviteve të ndryshme të realizuara nga pedagogët dhe studentët të FAB</i></p> <p>http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=17&niveli=85</p> <p>http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=129&niveli=97</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuar kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Për vetë natyrën e fakultetit të Arteve të Bukura, organizohen aktivite me punime të studentëve e cila drejtohet nga pedagogët e Programit, apo dhe në raste të veçanta këto aktivite realizohen nga vetë studentët e këtij Fakulteti, ose së bashku me pedagogët e lëndës. Gjithashtu një rol në mbështetjen e studentëve, luanjnë dhe Këshillat studentorë. Këshillat Studentore të Universitetit të Arteve kanë si objektiv të tyre të promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe të koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të Institucionit, në strukturat mësimore-kërkimore dhe ato të shërbimeve. Këshillat Studentore shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të Institucionit, si për planet ashtu edhe për programet e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



	studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, etj. http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=136&niveli=79 Evidencë. Nr. 32. Fletpalosje nga aktivitetet me studentët dhe Pedagogët e FAB.			
Konkluzione	Sipas dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se në lidhje me mbështetjen financiare të studimeve të përparuara, institucioni i mbështet studentët në mobilitetet që ata mund të zhvillojnë në shkolla të tjera europiane, duke përfshirë njohuri të reja.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x

Standardi III.5 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblyëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmblyëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	<p>Procedurat e diplomimit si dhe kriteret e hyrjes në diplomim janë të përcaktuara në Rregulloren e studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë Master, si dhe në Rregulloren e programit të studimit, ku paraqiten:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ modalitetet e diplomimit ✓ punimi i diplomës ✓ përgatitja e diplomës ✓ organizimi i mbrojtjes së diplomës ✓ vlerësimi i punimit ✓ lëshimi i diplomës ✓ suplementi i diplomës <p>Evidencë. Nr. 12. Rregullorja mësimore e ciklit të dytë të studimeve Master e UART, Kreu V; neni 18, 22, Kreu VIII. Evidencë, Nr. 9. Diploma, Suplementi i Diplomës dhe aneksi i diplomës http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=134&niveli=77</p>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmblyëse.	<p>Në Universitetin e Arteve, si strukturë e informimit dhe të këshillimit të studentëve përveç sekretarive mësimore të fakulteteve është edhe zyra e Sektorit Mësimor dhe Informimit të Studentëve. Informimi i studentëve kryhet nëpërmjet formave të ndryshme, si për shembull këshillimit dhe informimin online nëpërmjet faqes zyrtare të UART, siç është Faqja elektronike e Fakultetit të Arteve të Bukura. Personeli akademik informon studentët nëpërmjet kontakteve të herëpashershme dhe të vazhdueshme me ta duke i udhëzuar me detyrimet përmblyëse dhe kryesisht me punimin e diplomës.</p> <p>Sipas Rregullores së programit të studimit, dy muaj pas fillimit të vitit të dytë akademik, studentëve u jepet informacioni mbi temën e diplomës si dhe paraprakisht orientohen drejt fushave dhe temave që ata mund të zgjedhin. http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=9&niveli=83</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

40

	<p>http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=5&niveli=9 http://uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=135&niveli=78</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Përgatitja dhe paraqitja e punimit/programit të diplomës në Fakultetin e Arteve të Bukura ndjek normat e përcaktuara dhe hapat proceduriale të përcaktuara dhe në “Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Arteve të Bukura”. Punimi i diplomës përmban një sërë detyrimesh e kërkesash, dhe bazohet në testimin e njohuritë praktike e teroike që studenti ka përfuar gjatë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 11. “Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Arteve të Bukura” neni 47</i> <i>Evidencë. Nr. 12.1. dhe 11. “Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Skulpturës”, Fakulteti i Arteve të Bukura</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmblyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Udhëheqësi i temës së diplomës, në bashkëpunim me studentin, përcakton programin e diplomës, duke vendosur edhe afatet e përafërta e periodike për çdo rubrikë të programit të diplomës. I gjithë semestri i dytë i vitit të dytë të studimit Master, i kushtohet përgatitjes së diplomës nga studentin. Përgatitja e diplomës konsiston në takime sipas orarit të mësimit të përcaktuar që në fillim të vitit akademik. Takimet për përgatitjen e mbrojtjes së diplomës kryhen në mënyrë individuale (ose në grup), dhe çdo student duhet të respektojë afatet për të bërë të mundur realizimin me sukses të programit për mbrojtjen e diplomës në sezonin e caktuar të tij.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 11. “Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Arteve të Bukura” neni 48</i> <i>Evidencë. Nr. 12.1. “Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Skulpturës”.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Institucioni i asiston dhe i mbështet studentët për kryerjen e projekteve artistike duke respektuar maksimalisht profilin e tyre individual, si dhe për zhvillimin e metodave, përpunimin e të dhënave, të përfuara në terren, si dhe analizimin e tyre, për interpretimin sa më artistik e po ashtu teorik. Projektet artistike mbështeten nga Departamenti i Skulpturës, në drejtim të mbështetjes infrastrukurore dhe pjesës së mentorimit e zhvillimit të tyre.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 33. Projekte artistike studentësh mbështetur nga Departamenti i Skulpturës.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të procesit të provimit të diplomës, Kryetari i Komisionit, mbledh anëtarët e komisionit për vlerësimin e punimit të diplomantit. Çdo anëtar i komisionit bën vlerësimin me pikë për çdo diplomant duke e nënshkruar atë. Pasi bëhet mesatarizimi i vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit dhe në prani të tyre, komisioni i komunikon çdo diplomanti notën me të cilën është vlerësuar. Vlerësimi i anëtarëve të komisionit dokumentohet dhe i bashkëngjitet proces-verbalit të mbrojtjes së diplomave, në të cilin shënohet nota përfundimtare.</p>

	<i>Evidencë. Nr. 11. "Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Arteve të Bukura" neni 50</i> <i>Evidencë. Nr. 12. 1. "Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Skulpturës".</i>			
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me suplementin e saj. Institucioni ndjek procedurat e duhura për diplomën e studentit sipas hapave dhe rregullave të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, dhe bazuar tek aktet ligjore në fuqi. <i>Evidencë. Nr. 11. "Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Arteve të Bukura" neni 51</i> <i>Evidencë. Nr. 12. 1. "Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Departamentit të Skulpturës".</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Informacioni i veprimtarisë akademike në UART përpunohet në hardcopy dhe në formë elektronike dhe ruhet në arkivin e institucionit. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit. Në lidhje me procedurat që kryhen për ruajtjen dhe arkivimin e informacionit dhe pajisjen e studentit me informacionin e nevojshëm, institucioni i ka të përcaktuara në dokumenta të veçanta.			
Konkluzione	<i>Sipas dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm, aspekte të cilat janë paraqitur në rregulloren e programit të studimit, si dhe të fakultetit.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x

Standardi III.6


Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Nuk aplikohet për këtë program pasi programi është Master i Arteve
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfundimin	Nuk aplikohet për këtë program pasi programi është Master i Arteve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.				
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Nuk aplikohet për këtë program pasi programi është Master i Arteve			
Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar dhe Ligjit për Arsimin e Lartë, 80/2015, Neni 21, referuar përshkrimit dhe detyrave të punës së personelit ndihmës dhe bisedës me ta, konfirmuam se, Drejtoria e Komunikimit dhe e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për sigurimin zbatimin e politikave të menaxhimit me efektivitet të burimeve njerëzore. Sektori i burimeve njerëzore në UART merret me procedurat e rekrutimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesëshme. Gjithashtu krijon, plotëson, përditëson dhe përshkruan mangësitë e dosjes personale të personelit akademik dhe personelit ndihmës. Ky sektor përgatit shkresa të ndryshme, protokollon, raporton, zbaton vendimet e Senatit , plotëson regjistrin themeltar dhe mban evidencën për ngarkesën e stafit mësimor për çdo semestër. <i>Evidencë RVB; Vizita në institucion</i> <i>Evidencë 48. Rregullorja e funksionimit të Sekretarisë Mësimore FAB</i> <i>Evidencë Nr.11. Rregullorja FAB</i> <i>Evidencë Nr. 48.1 dhe 2. Screenshot nga regjistri i FAB dhe komunikimi me email me studentët dhe pedagogët e FAB</i>



<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Sektor që administron Burimet Njerëzore dhe Dokumentacionin zbaton një procedurë rekrutimi për personel akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme sipas kërkesave të përcjella nga dekanët dhe nga Rektori duke respektuar statutin, rregulloren, nevojat e deparatamentit dhe akteve të tjera të brendshme. Hapi i parë është nxjerrja e njoftimit online me të gjitha kriteret e listuar dhe përcaktuara.</p> <p>Në takimin me stafin e zyrës së burimeve njerëzore të institucionit GVJ u njoh me të gjithë procedurën e rekrutimit të stafit, me modelet e kontratave të punës për PAE, PAK, verifikoi me sondazh dosje të personelit akademik, kontratat e punës të stafit akademik efektiv dhe me kontratë.</p> <p>Dosja e stafit akademik të UAT përmban:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dokumentacionin që ka dorëzuar në momentin e aplikimit. 2. Librezën e punës 3. Curriculum Vitae 4. Listë notash, Diplomë, Diplomë gjuhe të huaj, dëshmi penaliteti, raport mjeko ligjor. 5. Fotokopje ID 6. Procedurën e punësimit 7. Vlerësimin e fazës së konkursit <p>Rekrutimi i stafit kryhet sipas akteve rregullatore të miratuar nga UART dhe kodit të punës. Në diskutimin me pedagogët u konstatua se ata njihen paraprakisht me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga lidhja e kontratës së punës.</p> <p><i>Evidencë Nr. 7. Statuti i UART</i> <i>Evidencë Nr.15 Realizimi i Marrëveshjeve vjetore NJËSIA BAZË</i> <i>Evidencë Nr.15.2 Marrëveshje vjetore tip me një pedagog.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Bazuar në statutin e UART dhe kodin e punës është hartuar procedura me kriteret për rekrutimin e personelit. Parashikimet për staf të ri bëhen për çdo vit akademik nga departamenti.</p> <p>Çdo vit departamentet bëjnë përcaktimin e stafit akademik që përfshihet në programin e studimit, ngarkesën mësimore sipas semestrave dhe vjetore. Në bazë të ngarkesës mësimore të stafit, departamenti bën planifikimin e pedagogëve si dhe i paraqet dekanatit kërkesën nëse ka nevoja për rekrutim të stafi akademik dhe jo akademik të nevojshëm për realizimin e këtij e programit studimi. Departamenti i përcjell kërkesat e tij në dekanat dhe me pas dekanati i përcjell në rektorat dhe pas rektoratit ato kalojnë për miratim në senat. Pasi miratohen në senat vendet e lira të punës shpallen në faqen e WEB-it të universitetit ku publikohen kriteret e përgjithshme dhe specifike për vendin e punës si dhe dokumentacioni që duhet të dorëzohet çdo kandidat, afatet kohore për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm si dhe tabela e pikëzimit..</p> <p>Dorëzimi i dokumentacionit bëhet me rrugë postare.</p> <p><i>Evidenca 7. Statuti UART, neni 56, Punësimi i Personelit Akademik me kohë të plotë. neni 57,</i> <i>Punësimi i personelit akademik me kohë të pjesëshme</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Rekrutimi i stafit akademik përcaktohet nga departamenti përgjegjës në bazë të nevojave specifike dhe i përcillen zyrës së burimeve njerëzore. Pas shpalljes së vendit vakant, dekani ngre komision “ad hoc” që do të realizoj procedurën për rekrutimin e stafit akademik. Konkurimi kalon në dy faza:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësim në bazë të dosjes 2. Intervista <p>Kur një dosje skualifikohet, Drejtorja e Burimeve Njerëzore lajmëron kandidatin dhe ai brenda afatit kohor prej 10 ditësh duhet të drejtojë ankimim me shkrim nëse ka. Për çdo fazë vlerësimi pritet 5 ditë pas shpalljes së vlerësimit për ankimime nëse ka. Nëse nuk ka ankimim, mbyllet procedura e vlerësimit dhe vendimi i komisioni i përcillet dekanit.</p> <p>Evidenca 7. Statuti i UART , neni 56</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni siguron dhe garanton hapësira fizike dhe zgjedh mundësi të përshtatshme për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale dhe cilësore.</p> <p>Sallat e leksioneve, ambienti i departamentit kishin infrastrukturë të përshtatshme (hapësira, salla leksioni, atelje, reparte ndihmëse dhe shërbimi kompjutera, tri salla për aktivitete shërbimi dhe promovimi të shfrytëzueshme bibliotekë, hapësira e sekretarisë, reparte pune dhe shërbimi, laborator i multimedias), të cilat grupi ynë i pa të gjitha gjatë vizitës në institucion. Zyrat e stafit janë të paisura me tavolina pune, kompjutera personal, printera, fotokopje etj si dhe materiale kancelarie për kryerjen e procesit mësimor. Sekretaria ka ambiente të bollshme dhe bashkëkohore për pritjen e studentëve dhe kryerjen e detyrave të saj funksionale. Institucioni ka ambiente të dedikuara për arkivën.</p> <p>Evidenca 22.2. Infrastruktura pdf</p> <p>Evidenca Manuali Pitagore</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Referuar VKM dhe gjatë takimit me personelin, u informuam rreth angazhimit të institucionit për kualifikimin e vazhdueshëm dhe përditësimin e këtij informacioni si për stafin e punësuar me kohë të plotë dhe stafin epunësuar me kohë të pjesshme. Gjatë konsultimit me DVV dhe komunikimi me zyrën përkatëse u konstatua se të gjitha të dhënat e personelit akademik që lidhen me kualifikimin e tyre, aktivitetin artistik, aktivitetin shkencor konservohen në dosjen personale dhe materiali administrohet nga Burimet Njerëzore. GVJ konstatoi se dosja e stafit akademik identifikohet si objekt përditësimi i përvitshëm dhe mbledh të gjitha të dhënat e stafit akademik. Të gjitha kualifikimet brenda dhe jashtë vendit, përditësohen me dokumentacion mbështetës.</p> <p><i>GVJ konstatoi këto informacione në takimin me personelin dhe me dokumentacionin përkatës</i></p> <p>Evidencë Nr. 5. Udhëzimi Nr.29, datë 10.09.2018</p> <p>Evidencë Nr.5.1. VKM Nr.329, datë 12.04.2017</p> <p>Evidencë Nr. 22.4 Realizimi i Marrëveshjeve vjetore Njësia Bazë</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

45


<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në Udhëzimin 29, të vitit 2018, institucionin; përputhje me programin mësimor ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione për të kryer. GVJ nga konsultimet me dokumentacionin përkatës dhe komunikimeve me stafin akademik dhe titullarët konstatoi se Studentët e Programit të Studimit Master i Arteve, e kanë kusht të panegociushëm që të realizojnë praktikën mësimore pranë një institucioni të arsimit parauniversitar, në përputhje me parashikimet e planit mësimor dhe në mbështetje të lëndëve specifike të mësuesisë.</p> <p>Parimisht dhe praktikisht Departamenti dhe FAB, nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi me institucionet arsimore pranë të cilit do të zhvillohet praktikën ku parashikohen</p> <p>Shkolla pranë të cilës zhvillohet praktika mësimore;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Numri i studentëve për çdo shkollë. <p>Departamenti ka prioritet përcaktimin e pedagogëve, në varësi të numrit të studentëve për të ndjekur praktikën dhe për të mbajtur kontakt me institucionin pritis.</p> <p><i>Evidencë Nr. 5. Udhëzimi Nr.29, datë 10.09.2018</i> <i>Evidencë Nr. 22.3 Dosja e Praktikës Profesionale</i></p>			
<p>Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritis që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion u konsultua me personelin mbikëqyrës në ambientin pritis që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale dhe në bazë të marrëveshjeve ndihmon studentët që të në përmbushin detyrimet/raportin përfundimtar të praktikës si dhe marrin pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. Marrëveshja parashikon angazhimin nga një përfaqësuesi nga secili institucion , nje për mbikëqyrjen e praktikës dhe një përfaqësues të institucionit pritis. Përfaqësuesi i institucionit pritis ka për detyrë të ndjekë, ndihmojë, mbikëqyr studentin gjatë zhvillimit të praktikës, në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar. Në përfundim të praktikës, përfaqësuesi i institucionit pritis, ka një vlerësim të detajuar për studentin praktikant. Referuar dosjes së praktikës profesionale, praktika mësimore parashikohet si pjesë e planeve mësimore dhe përmban një numër kreditesh të caktuara,</p> <p><i>Evidencë Nr. 22.3 Dosja e Praktikës Profesionale</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se procedurat e ndjekura nga burimet njerëzore ndjekin me korrektësi të gjitha procedurat administrative për punësimin e stafit akademik, ndërkohë institucioni harton dhe zhvillon me prioritet të gjitha procedurat e nevojshme për përmbushjen e standartit të organizimit të një praktike cilësore të studentëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standartit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">x</p>

Standardi IV.2

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>UART siguron infrastrukturën e nevojshme dhe të përshtatshme për përmbushjen e nevojave të mësimdhënies dhe veprimtarisë artistike, kërkimore – shkencore. UART, ka një sipërfaqe që plotëson të gjitha kriteret e nevojshme për të zhvilluar të gjitha aktivitetet.</p> <p>Në konsultë me dokumentacionin dhe gjatë vizitës u konstatua se FAB ka të gjithë hapësirën e nevojshme për të zhvilluar këtë program. Vetë natyra specifike të programit të Studimit Master kërkon mjediset e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor, mundësojnë praninë e një numri të gjerë studentesh dhe garantojnë edhe cilësinë e programit.</p> <p>Në mbështetje të mësimdhënies për FAB, pjesë e të cilit është edhe Departamenti i Skulpturës, i cili ofron programin e studimit objekt vlerësimi, vë në dispozicion mjedise me përmasa të mjaftueshme. Atelie, me ndriçim natyral, të cilat u japin studentëve hapësirën e nevojshme për proceset e punës në dhe jo vetëm, si kusht për cilësinë e produktit artistik.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u panë të gjitha këto ambiente dhe u vu re që janë optimale e në përputhje me natyrën specifike të programit. Hapësira të veçanta ishin Atelietë ku studentët kompozonin në gjininë e pikturës, grafikës, skulpturës, modës dhe gjini të tjera . Këto atelie për shkak të specifikës së tyre ku proceset kryhen me dorë dhe me syrin e studentit dhe janë procese tërësisht individuale. Programi ka mjediset të tjera ku prania e teknologjisë është faktor mbështetës në lektorim, ose në tridimensional.</p> <p>Galeria FAB e konceptuar në 3 hapësira dhe përbente një aset të rëndësishëm në përmbushjen e procesit krijues dhe në përmbijlljen e tij me ekspozimin e punëve të studentëve e pedagogeve, ekspozita sipas secilit program studimi. Galeria është hapësirë një hapësirë më shumë në skenën e artit bashkëkohorë shqiptar, me shumë aktivitete artistike në vit, dhe me një numër të konsiderueshëm vizitorësh, duke u kthyer në një arenë dialogu dhe ballafaqimi midis punëve të studenteve dhe publikut.</p> <p>Së bashku me ambientet e studiove në dispozicion janë edhe sallat e performancave Black-Box, me dy mjediset përkatësisht 40 dhe 200 vende spektatorësh dhe me hapësira të bollshme skenike. Këto salla ofrojnë forma të ndryshme ekspozimi, e falë pajisjes me infrastrukturë kompjuterike dhe audio-vizuale dhe sallën e kontrollit në shërbim të sistemit audio dhe projeksion multimedial.</p> <p>Sipas kërkesave të projekteve edhe më të mëdha institucioni vë në dispozicion edhe mjediset tjera të përbashkëta. Referuar vizitës në</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

47

	<p>institucion konstatuam se FAB gjendet në godinën C të UART, në një ndërtesë e cila është përfunduar në vitin 1972. Sipërfaqja totale e objektit sipas dokumentacionit të referuar saktë në dokumentacion me sipërfaqe ambiente mësimi; Sipërfaqe në funksion të zyrave; 47II. Salla e Lektorium. një mjedis i përbashkët që përdoret nga secili program në varësi të projekteve artistike, sipas një kalendarit të konfirmuar nga sekretaritet referuese. Planimetria e Katit 1 dhe 2 e organizuar në klasa mësimore. Gjatë vizitës në këto ambiente u konstatua ndriçim natyral të përshtatshëm për zhvillimin e veprimtarisë mësimore.</p> <p>Evidencë 22.2 Dosja e infrastrukturës FAB dhe ambienteve të përbashkëta</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Galeria FAB, salla Black-Box” dhe mjediset mbështetëse të regjistrues shërbëjnë si ambiente për të zhvilluar programin e ciklit të dytë. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se sallat në funksion të aktiviteteve artistike por edhe të ekspozitave të këtij programi. Për vetë specifikën që mbart ky program është e rëndësishme pajisja me aparatura të teknologjisë, GVJ-ja konstatoi se ambientet ku zhvillohej ky program ishte i pajisur me infrastrukturën e nevojshme për secilin student. Gjatë vizitës në institucion GVJ pati mundësinë të vizitojë. Hapësirat e sipërpërmendura ndihmojnë trupën e profesorëve dhe të studentëve të kenë hapësirën dhe materialet e nevojshme për të garantuar zhvillimin cilësor si të programit teorik dhe atij praktik.</p> <p>Evidencë 22.2 Dosja e infrastrukturës FAB dhe ambienteve të përbashkëta</p> <p>Evidencë 22.2. 1 Lista e pajisjeve në shërbim të NJËSIA BAZË për vitet 2022-2025</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës dy ditore vëzhgoi studiot dhe laboratorët e FAB/UART. GVJ-ja konstatoi se këto ambiente kanë të gjithë aparaturat e nevojshme për realizimin e objektivave të këtij programi. Këto aparatura përmbushin kriteret për formimin teorik dhe praktik të studentëve. Për vetë specifikën e programit të studimit pajisjet dhe aparaturat që përdoren në Departamentin e Skulpturës në shërbim të realizimit të programeve speciale në pjesën më të madhe janë pajisje dhe aparatura të standarteve të larta. Studentëve u ofrohen mundësitë të njihen, prekin e përdorin, fjalën e fundit të teknologjisë në specifikën përkatëse. Laboratori i Multimedia ka 7 kompjutera IMac dhe të instaluar të gjitha programet e nevojshme që ndihmojnë studentët të realizojnë dhe praktikojnë vizatimin digjital. Infrastruktura ka si pjesë të saj dhe printerat 3D. Biblioteka mbart rreth 20 kompjutera të shfrytëzueshëm nga stafi akademik dhe nga të gjithë studentët.</p> <p>Evidencë 22.2 Dosja e infrastrukturës FAB dhe ambienteve të përbashkëta</p>

	<i>Evidencë 22.2. 1 Lista e pajisjeve në shërbim të NJËSIA BAZË për vitet 2022-2025</i>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni ka siguruar hapësira të mjaftueshme në mjedise të përshtatshme referuar numrit të sallave të leksioneve, numrit të sallave të seminareve, objektet bazike, dërrasa, tavolina, karrige GVJ i preku gjatë vizitës në institucion. Nisur dhe nga profili i programit dhe numri i studentëve, këto ambiente konsiderohen të përshtatshme</p> <p>Programi ka të dedikuar një laborator i cili ishte rinovuar dhe u vizitua nga GVJ</p> <p>Gjatë vizitës u konstatua se laboratori ka në dispozicion</p> <p>7 kompjutera IMAC high Sierra (Version 10.13.3)</p> <p>2 të Illojit MacOS të llojit MacOS Mojave(Version 10.14.6)iMac(Retina 4K, 21.5. inch 2017)</p> <p>Scanner 3D</p> <p>Printer 3D</p> <p>U informuam që programet Adobe CC, Adobe Photoshop CC, Adobe Illustrator CC dhe paketat Microsoft Word, one Note, Power Point, Excel, Out look Wacom Desktop Center.</p> <p>GVJ konstatoi që laboratori përmban pajisjet klasike dhe të viteve të fundit të cilat ndihmojnë në përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi” parashikon praktika të cilat zhvillohen në programet e studimit në Departamentin e Skulpturës. Studentët ndjekin praktika profesionale dhe artistike dhe praktika mësimore.</p> <p>Praktikat profesionale artistike organizohet në përputhje me specifikën e programit të studimit, materializohet në përfundimin e përvojave dhe perceptimin individual dhe artistike sipas programit për çdo disiplinë studimi.</p> <p>Praktika profesionale zhvillohet në ambientet e UART (atelje) me të gjithë infrastrukturën e nevojshme, ose në institucionet që janë partnere të UART. Praktikat profesionale zhvillohen në të ty ciklet studimeve. Në kuadër të Programit të Studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi” zhvillohen vetëm praktika mësimore. Praktikat mësimore zhvillohen në marrëveshje me DAR të të gjithë qyeteteve dhe pranë institucioneve të arsimit parauniversitar. Në lidhje me këtë FAB ka të nënshkruara marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p><i>Evidencë Nr. 22.3 Dosja e Praktikës Profesionale</i></p>

Konkluzione	<i>Institucioni përpiqet të sigurojë dhe të përmirojë vazhdimisht infrastrukturën. Institucioni siguron hapësiësirën e nevojshme, laboratorët, bibliotekën dhe në marrëveshje me të gjithë institucionet e tjera për të realizuar praktikat profesionale dhe mësimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>GVJ kosntaton se në syllabusin e çdo lënde të këtij programi parashikohet literatura bazë dhe ndihmëse. Ky element parashikohet në përputhje me Rregulloren e FAB. Studentëve ju mundësohet qasja në literaturën e lëndës sipas formave të parashikuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hard copy në Bibliotekën e UART; - të shtypur (printuar nga vetë pedagogu), në rastin e leksioneve të hartuara (nëse e parashikon specifika e lëndës); - Nëpërmjet paraqitjes së linkut ku mund të gjendet materiali i parashikuar. <p>GVJ vizitoi bibliotekën dhe u informua me tituj dhe literaturën në funksion të këtij programi. Literaturë e përgjithshme si dhe monografi shkencore në gjuhën shqipe mbi artin para viteve '90 të cilat ishin në process të dixhitalizimit, tituj të shumtë periodik, gazeta, revista si dhe artikuj të ndryshëm për artin. Literatura përmban nga fondi referues: enciklopedi, estetikë, periodikë shqiptarë, retrospektivë. Gjithashtu ekziston edhe një listë të burimeve elektronike. Ky ambient ishte i shfrytëzueshëm nga studentët e të gjitha cikleve.</p> <p><i>Evidencë Nr. 22 Kurrikula e Programit të Studimit Master</i></p> <p><i>Evidencë 42. Lista e literaturës NJËSIA BAZË në Bibliotekën e UART</i></p>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	<p>GVJ-ja u konsultua me dokumentacionin dhe konstatoi se Departamenti i Arteve në fillim të çdo viti akademik, ka prioritet njoftimin pedagogëve për afatet e rishikimit të programeve të lëndëve (syllabuset). Prioritet kanë propozimet e për hulumtimet e kryera dhe veçmas parashikohet përditësimi i literaturës dhe pasurimin me materiale (libra, artikuj etj) të tjera. Urë lidhëse e këtij procesi është Rektori, i cili bashkëpunon me Fondacionin për Arsimin për këtë proces.</p> <p>Literatura përmban botime të reja, revista artistike të vendeve të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

50

	<p>ndryshme si dhe tituj veprash dramatike të cilat janë edhe elementi më i kërkuar nga pedagogët dhe studentët e Departamentit të Skulpturës. Egziton një hapësirë boshe lidhur me botimet në gjuhën shqipe dhe literatura është kushëtuar të jetë në gjuhët kryesore evropiane, kryesisht në anglisht dhe frëngjisht.</p> <p><i>Evidencë Nr. 42. Lista e literaturës NJËSIA BAZË në Bibliotekën e UART</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Siç u vu re edhe gjatë vizitës, Biblioteka e Universitetit të Arteve ka në përbërje dy salla (laboratorë) në shërbim të studentëve, salla e Fondit të Hapur dhe salla “Media Library”. Këto salla janë të pajisura me infrastrukturë rrjeti kompjuterik dhe shfrytëzohen nga studentët e të gjitha profileve të studimit në Universitetin e Arteve, për të tre Fakultetet përfshirë edhe studentët e Programit të Studimit Master i Arteve në “Skulpturë dhe Mësuesi”. Në këto salla mund të punohet me editim jo-linear audio, montazh fotografik, dizajn grafik, dizajn 3 dimensional, editim jo-linear video/ montazh filmik, dizajn inxhinierik, procese office, punë kërkimore shkencore, etj. Në këto salla aksesohen burimet elektronike të vetë Bibliotekës së Arteve, si dhe burime të shumta elektronike online, të cilat i janë mundësuar UART.</p> <p><i>Biblioteka online në webb faqen e UART</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me një numër të konsiderueshëm tekstesh në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Gjithsesi në raportin e brendshëm, inventari është përshkruar në nivel institucional dhe jo në titujt që kanë lidhje me këtë program studimi.</p> <p>Gjatë vizitës u vu re një numër librash bazë të domsdoshëm për këtë program. <i>Vetë institucioni përpiqet të përditësojë dhe pasurojë bibliotekën me tituj cilësorë e të rinj në ndihmë të studentëve, dhe stafit akademik ose nga buxheti i programuar të ofrojë abonim në revista shkencore ose në biblioteka digjitale të univeriteteve të njohura që kanë të njëjtin program studimi.</i></p> <p>Po ashtu funksionon edhe sistemi i arkivit digjital, përmes të cilit përdoruesit kanë mundësi të shfletojnë materialet në trajtën elektronike (digjitale).</p> <p>FAB/UART, ndjek një politikë të ruajtjes së trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore, nëpërmjet depozitimit në Bibliotekën e UART të materialeve të krijuara ndër vite.</p> <p>Biblioteka e UART i ofron koleksionet dhe shërbimet e saj nëpërmjet ambienteve si (sallë e cila i jep mundësinë përdoruesve të bibliotekës të shfrytëzojnë pa limit librin që dëshirojnë dhe duke fotokopjuar atë çka</p>

	studentët dëshirojnë) dhe fondi i mbyllur (literaturë e artit dramatik si teori drame; punime teorike; përkthime; drama; tregime; romane, etj
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Institucioni në bashkëpunim me MASR ka vendosur në dispozicion librarinë online. Aksesit në këtë librari është si për studentët dhe për personelin akademik. Salla multimediale e Bibliotekës së UART ofron kushte komode. Kjo sallë është e pajisur me teknologjinë e re, në shërbim të plotë të studentëve, pedagogëve, studiuesve të artit. <i>Lista e burimeve elektronike në të cilat ka akses UART në rrugë digjitale</i> është pa pagesë.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Institucioni ka bërë përpjekje për të investuar në infrastrukturë. Të tri godinat kanë një numër të përcaktuar kompjuterash dhe pajisjesh. Interneti pa limit dhe shtimi i numrit të kompjuterave ndihmon studentët për ta bërë më të aksesueshëm gjithë informacionin që mund të merret. GVJ-ja konstatoi se biblioteka përbëhej nga “Salla Multimediale” e cila është e pajisur me 20 kompjutera me qasje në internet të pajisur me software specifik në mbështetje të punës studimore edhe në fushën e muzikës. Sipas statistikave ato disponojnë: <i>Salla me fonde të hapura (4 kompjutera);</i> <i>Salla multimediale (20 kompjutera);</i> <i>Zyrat e përpunimit të informacionit (6 kompjutera);</i> <i>Katalogu online (2 kompjutera);</i> <i>Pajisje multifunksionale (3 Printera, 3 skanera, 2 fotokopje);</i> <i>Servera (3);</i> <i>Raku-Gramafon, manjetofofon, kasetofon etj.</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Sipas Neni 21 i Rregullores së Bibliotekës, biblioteka qëndron e hapur duke nisur prej orës 08:00, orë në të cilën nis edhe procesi mësimor, e në vazhdim. Ndërtesat që shërbejnë si bibliotekë qëndrojnë të hapura gjatë ditëve të javës në përputhje me procesin mësimor. Në mënyrë të veçantë, përgjatë sezoneve të provimeve, biblioteka e UART, për të plotësuar kërkesat e shtuara të studentëve dhe stafit akademik, punon me orar të zgjatur, bazuar në kërkesat e Fakulteteve të UART. <i>Rregullorja e funksionimit të bibliotekës UART</i>

<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse raporton për fondin fizik në dispozicion (tituj, tekste, drama, revista, buletine, etj) dhe frekuentimin e ambienteve të bibliotekës sikurse dhe online. Përgjegjësi i departamentit shkon rregullisht në bibliotekë dhe hartojnë kërkesat specifike për programin e tyre.</p> <p><i>Evidencë Nr. 42. Lista gjithëpërfshirëse e titujve fizikë në bibliotekën e UART</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Lidhur me literaturën e nevojshme, GVJ konstaton se institucioni i kushton kujdes të veçantë infrastrukturës së ndërtimit dhe sigurimit të hapësirës së hulumtimit dhe pasurimit me literaturën e nevojshme. Hapësirat e studimit organizohen në dobi të gjithë studentëve dhe stafit akademik.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>x</p>

<p>Standardi IV.4</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit administrojnë gjithë informacionin që lidhet me studentët. Ai disponon të tre llojet e regjistrave në formë shkresore dhe elektronike, dosjet e regjistrimit dhe diplomimit, dhe gjithë procesverbalet e rezultateve të studentëve. Të dhënat janë të hedhura në platformën digjitale dhe ndihmon studentët të kenë akses për një numër informacionesh.</p> <p><i>Evidencë 48. Rregullorja e funksionimit të Sekretarisë Mësimore FAB</i></p> <p><i>Evidencë Nr.11. Rregullorja FAB</i></p> <p><i>Evidencë Nr. 48.1 dhe 2. Screenshot nga regjistri i FAB dhe komunikimi me email me studentët dhe pedagogët e FAB</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin</p>	<p>UART ka një sistem të brendshëm menaxhimi që administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit. Sistemi</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

53

<p>dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Pitagora është inaguruar këtë vit akademik. Para këtij Sistemi, UART ka aplikuar sistemi elektronik ESSE 3. Ky sistem shërben për të menaxhuar plotësisht informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit si dhe është detyrim i stafit akademik që në përfundim të çdo viti akademik të përditësoj dosjen e tij fizike pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.</p> <p><i>Evidencë Nr. 7. Statuti i UART</i> <i>Evidencë Nr.15 Realizimi i Marrëveshjeve vjetore NJËSIA BAZË</i> <i>Evidencë Nr.15.2 Marrëveshje vjetore tip me një pedagog.</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Siç cituam më sipër, institucioni ka një sistem të brendshëm menaxhimi elektronik, i cili nëpërmjet web-it (www.uart.edu.al/) bëhet sigurimi i informacionit dhe dokumentacioneve të nevojshme për studentët dhe stafin akademik.</p> <p>Sekretaria ka aksesuar administrimin e të dhënave të stafit akademik dhe të personelit ndihmës. Gjithsesi sektori i burimeve njerëzore dhe i kurrikulave kryen të gjithë procedurat përkatëse për çdo punonjës të stafit akademik, personelit ndihmës, dhe disponon dosje personale me përditësimin e çdo informacioni.</p> <p><i>Evidencë 43. Manuali Pitagora</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi Pitagora siguron akses dhe është i dedikuar për të mundësuar shërbime për të gjithë personat e autorizuar që kanë një llogari personale të universitetit. Çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidenciale merr informacion për rezultatet e provimeve gjatë vitit akademik. Informacionet personale për stafin akademik administrohen në mënyrë konfidenciale nga strukturat e UV bazuar në Ligjin “Për mbrojtjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”.</p> <p><i>Evidencë Nr.43. Manuali Pitagora</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Secili pedagog mund të shpërndajë leksione dhe informacione shtesë në sistemin Pitagora për studentët e tij dhe ndërkohë ata mund të përcjellin dhe mendimin e tyre rreth leksionit duke ruajtur anonimat. Sistemi i menaxhimit të integruar Pitagora shkon dhe në ndihmë të shkresave zyrtare që sekretaritë mësimore duhet t’u shpërndajnë studentëve.</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Sistemi garanton monitorimin në kohë reale të aktiviteteve akademike, mundëson raporte individuale. Sipas nevojave, sistemi ndihmon aksesimin e të dhënave, tarifave, afatet e e hedhjes së vlerësimeve.</p> <p>Faqja e Web-it e universitetit publikon të gjitha informacionet zyrtare që lidhen me programin e studimit duke ndjekur politikat institucionale. Të gjithë informacionet publikohen në të dyja gjuhët.</p> <p><i>Evidencë 5.25. faqja web e UART</i> www.uart.edu.al</p>


Konkluzione	<i>GVJ konstaton se sistemi i menaxhimit të të dhënave të informacionit funksionon dhe është i aksesueshem dhe efikas si për studentët ashtu dhe për stafin akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	<p>Nga takimi u konfirmua se institucioni harton një raport financiar që pasqyron koston financiare mesatare për çdo student në nivel universiteti. Fillesa e raportit nis nga njësi bazë që është departamenti.</p> <p>Planifikimi financiar nis çdo fillim vit kalendarik bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010. Në kërkesat e paraqitura në funksion të mbështetjes financiare të programeve të studimit në varësi të saj.</p> <p><i>Evidencë 63. Paraqitja e buxhetit nga administrator i FAB</i></p> <p><i>Evidencë 63. 1. VBA për miratimin e buxhetit</i></p>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Në përputhje me strukturën e buxhetit, institucioni ndjek të dy fazat e hartimit të buxheti. Ai që vihet në dispozicion nga granti i pakushtëzuar i MASR -i, buxheti i shtetit dhe nga buxheti i i universitetit. Hartimi i buxhetit nis nga njësi bazë e cila llogarit të gjitha shpenzimet për këtë program studimi dhe më tej koordinohen në nivel fakultetit dhe me strukturata e tjera. Drejtoria e Shërbimeve mbështetëse mbledh të dhënat nga shërbimet mbështetëse dhe paraqet planin për vitin në perspektive duke e paraqitur tek Rektorati dhe Senati Akademik.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Mbështetur në VKM Nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në Sektorin publik”, pika 1, b. - <i>Njësitë e auditimit krijohen në çdo institucion tjetër që kryen funksione publike, shoqëri tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme, si</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



55

	<p><i>dhe njësi të tjera që shpenzojnë fonde publike sipas një marrëveshje ndërkombëtare, të cilat kanë në vit, njëkohësisht jo më pak se 400.000.000 (katërqind milionë) lekë të ardhura financiare dhe 300 punonjës, përgjatë 3 (tri) viteve të fundit të veprimtarisë së tyre, me përjashtim të rasteve kur ngritja e njësisë së auditimit të brendshëm parashikohet nga një ligj i veçant. Megjithatë UART raporton në mënyrë periodike në MASR pasqyrat vjetore financiare</i></p> <p><i>Në qasjen tonë parimisht dhe praktikisht në të ardhmen UART do të duhet ti nënshtrohet auditit të jashtëm Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe MASR-së dhe auditit të brendshëm, një sektor më vete, bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe me vendimin e Senatit Akademik. Në fund auditit harton një raport periodik financiar të të ardhurave nga tarifat apo burimet e tjera. Administratori e paraqet këtë raport në Senatin Akademik i cili miratohet dhe protokollohet.</i></p> <p>Evidencë Nr. 63.4. Pasqyrimi financiar vjetor i vitit 2020</p> <p>Evidencë Nr.5.30. VKM Nr.83, datë 03.02.2016</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Sipas RVB në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni merr në analizë gjendjen financiare. Kjo bëhet jo vetëm për periudhën njëvjeçare por merr përsipër të kryejë krahasime dhe të bejë ndërhyrje dhe reflektime për secilin program. Një studim mirëfilli i tregut të punës dhe pritshmërive do të ndihmonte dhe për një financim akoma dhe më cilësor të këtij programi.</p> <p>Evidencë 63.3 Të ardhura që parashikohen të realizohen nga UART Janar – Maj 2022</p> <p>Evidencë. Dokumente nga drejtoria ekonomike mbi raportimin për realizimin e buxhetit</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Sipas RVB dhe konsultimit me dokumentacion, institucioni garanton qëndrueshmëri financiare duke u nisur nga dy burimet financiare:</p> <p>a-Grantet e MASR -së</p> <p>b-Fondet që sigurohen nga të ardhurat e universitetit.</p> <p>Institucioni garanton qëndrueshmëri financiare. Pasqyra financiare hartohet brenda afateve të përcaktuara. Gjithashtu UART ka aplikuar për projekte të cilat do të ishin një burim shtesë të ardhurash.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në qasjen tonë institucioni garanton financimin dhe mbështetjen e nevojshme me të ardhura por këshillohet parimisht dhe praktikisht organizimi i auditit të brendshëm.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>



				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



 57


V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Procedurat e pranimit, vazhdimi të programit të studimit dhe diplomimit janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, udhëzimet e MASR-së ligji nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, - legjislacionin në fuqi, në VKM-së Nr.145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të veçantë UA si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe <i>Statuti i UART, Rregullorja e Institucionit, Rregullorja e ciklit të dytë të studimeve</i>, dhe rregulloren e brendshme të institucionit, rregullores së departamentit duke filluar nga kriteri i mesatares në hyrje të programit, kohëzgjatjen zyrtare dhe shumën e krediteve në fund të programit janë lehtësisht të aksesueshme në web faqen (www.uart.edu.al.)</p> <p><i>Evidencë Nr. 1. Ligji nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”</i></p> <p><i>Evidencë Nr.7. Statuti i UART</i></p> <p><i>Evidencë Nr. 8. VKM Nr. 145, datë 10.03.2021 “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”.</i></p> <p><i>Evidencë Nr.10. Rregullore e UART</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Referuar Statutit të universitetit i cili mbështet parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, garantohet transparencë për kriteret hyrëse dhe të gjitha procedurat e nevojshme për çdo student duke përfshirë dhe transferimin e krediteve. Kandidati ndjek të gjitha hapat që i nevojiten kundrejt afateve ligjore të përcaktuara Numri i studentëve ndahet sipas zërave të përcaktuar më parë. Departamenti mbron studentët ndaj çdo lloj diskriminimi apo kriterëve të papërshtatshme. Të gjitha kriteret, procedurat apo ndonjë kërkesë mund të ketë qasje në web faqen zyrtare të UART, (www.uart.edu.al) si dhe nëpërmjet zyrave përkatëse të institucionit</p> <p><i>Evidencë Nr.7. Statuti i UART</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e</p>	<p>Kriteret e pranimit të studentëve dhe i transferimit të studimeve janë të paraqitura në Statut në dhe rregulloren e studentëve. Hap kyç është Ngritja e “Komisionit për ekuivalentimin e lëndëve” i cili në bashkëpunim me sekretarinë mësimore merret me të gjitha procedurat përkatëse.)</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




<p>ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p><i>Evidencë Nr.11. “Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e FAB”, Neni 24</i></p> <p><i>Evidencë Nr.13. Rregullore e Prog.Stud.</i></p> <p><i>Evidencë Nr. 43.1 Manuali i Transferimeve</i></p> <p><i>Evidencë Nr.7. Statuti i UART</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni miraton në Senatin Akademik të gjitha kriteret hyrëse në një program studimi. Referuar Udhëzimit të MASR-së, për kuota dhe kriteret, aplikantët duhet të kenë përfunduar Bachelorin në shtetin shqiptar apo jashtë, por më parë studentët që kanë përfunduar jashtë duhet të kryejnë ekuivalentimin e diplomës së fituar. Të gjitha këto informacione publikohen në faqen zyrtare të web -ti të universitetit dhe janë trasnparente.</p> <p><i>Evidencë Nr.11. “Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e FAB”, Neni 24</i></p> <p><i>Evidencë Nr.13. Rregullore e Prog.Stud.</i></p> <p><i>Evidencë Nr. 43.1 Manuali i Transferimeve</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Të gjitha kriteret e pranimit në këtë program janë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë nr 80/2015 dhe VKM – së për përcaktimin e notës mesatare, Udhëzimin e MASR-së, kriteret e pranimit në Master Institucioni parashikon kuota të veçanta për studentët e trojeve dhe studentët e huaj nga programi Erasmus. Dekani i FAB ngre grupin e punës si dhe përcakton detyrat dhe afatet në zbatim të akteve nënligjore për konkurset e pranimit. Ky urdhër publikohet në web faqe si dhe në të gjitha faqet elektronike të UART.</p> <p><i>Evidencë Nr.11. “Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e FAB”, Neni 24</i></p> <p><i>Evidencë Nr.44. Vendime të Senatit Akademik “Mbi miratimin e rregulloreve dhe kriterëve të konkursit të pranimit për vitin akademik 2022-2023” për FAB</i></p> <p><i>Evidencë Nr. 45. Vendime të Senatit Akademik “Për deklarimin e kuotave të pranimit të studentëve të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë bachelor dhe të ciklit të dytë master për vitin akademik 2022-2023 në Universitetin e Arteve”.</i></p> <p><i>Evidencë Nr.11. “Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e FAB”, Neni 24</i></p> <p><i>Evidencë Nr.13. Rregullore e Prog.Stud.</i></p> <p><i>Evidencë Nr. 43.1 Manuali i Transferimeve</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik</p>	<p>Gjatë gjithë vitit institucioni harton dhe realizon takime promovuese dhe organizon ditet e hapura. Gjithsesi vendosja e mesatares për këtë</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



59

<p>kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>program studimi ndikon edhe në numrin e nxënësve të cilët duan të ndjekin këtë program studimi. <i>Institucioni mund të përditësojë edhe format e promovimit apo të motivimit të studentëve për të rriur numrin e studentëve, në këtë program.</i></p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Gjatë gjithë vitit institucioni harton dhe realizon takime promovuese, organizon ditet e hapura. Gjithsesi vendosja e mesatares për këtë program studimi ndikon edhe në numrin e studentëve të cilët duan të ndjekin këtë program studimi.. Institucioni mund të përditësojë edhe format e promovimit apo të motivimit të studentëve për të rriur numrine studentëve, në këtë program. Studimet në FAB si program të dytë studimi, mund ti ndjekin edhe shtetas shqiptarë e të huaj që kanë përfunduar studimet e larta, kundrejt konkursit të pranimit si dhe pagesës së tarifës të miratuar nga Bordi i Administrimit, mbështetur në Vendimin e Senatit Akademik.</p> <p><i>Duke iu referuar aktivitetit, statusit të vecantë , misionit, dhe modelit të Universiteteve të Arteve të Bukura në Europë GVJ këshillon dhe modelin e studentëve “guest auditor”.</i></p> <p>Evidencë Nr. 13. Rregullore e Programit të Studimit neni 11. Pika 7.</p> <p>Evidencë Nr.11. “Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e FAB”, Neni 24</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Referuar Statuti të UART për përfitimin e bursave në bazë të kategorive përkatëse, institucioni harton politika të ndihmës,të cilat ndryshojnë çdo vit akademik. UART zbaton procedurat për pranimin e dokumentacionit sipas anës ligjore dhe nënligjore, dhe përcakton kuota pranimi të veçanta për këto shtresa në nevojë, si dhe për studentët që vijnë nga shtresa sociale “Rome/ Ballkano-Egjiptiane”, FAB këshi aplikues sipas kategorive, dhe miraton përfituesit.</p> <p>Evidencë Nr. 63.8. VKM nr 780, dt 26.12.2018. Për “përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për uljet e tarifës vjetore...”.</p> <p>Evidencë Nr.45.1. Kuotat e kërkuara në MAS nga FAB për vitin akademik 2020-2021 idencë Nr. 63.7. VBA 28 dt 30.12.2021.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Lidhur me shkallën e përbushjes se këtij kriteri GVJ konstatn se institucioni respekton të gjitha kriteret e kërkuar nga Ligji i Arsimit të lartë. Gjithashtu, referuar politikave të ndjekura nga Universitetet e tjera të Arteve në Europë këshillon modelin e “ guest student”.</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				x

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>GVJ zhvilloi takim me studentët dhe u konsultua me dokumentacionin e paraqitur. Në bisedën me studentët dhe në rregulloren e miratuar të institucionit GVJ u konstatua që institucioni përcjell dhe jep informacionin e nevojshëm për të ndihmuar studentin e këtij programi për përparimin akademik të tij. Çdo individ që fiton statusin e studentit pajiset me adresën elektronike, kodin unik në sistem, akses për të parë kontrollin e vlerësimit për çdo lëndë dhe përditësimin me çdo informacion të nevojshëm. UART ka përcaktuar një koordinator të studentëve dhe përgjegjesi i departamentit të cilët ofrojnë informacion e nevojshëm për çdo shqetësim apo problematikë.</p> <p><i>Evidencë Nr.11. “Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e FAB”, Kushtet e kalimit në vitin pasardhës, Kreu V, Neni 41, 42, 43, 44.</i></p> <p><i>Evidencë Nr. 13. Rregullore e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Programit të Studimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Siç parashikon Ligjin e Arsimit të Lartë 80/20155 institucioni aplikon procedurat për njohjen e krediteve dhe studimeve të mëparshme. Procedurat nisin pas kërkesës së studentit dhe plotësimin të formularit. Informacione gjenden në rregulloren e universitetit.</p> <p><i>Evidencë Nr. 13. Rregullore e Programit të Studimit, Pranimi i studentëve, Neni 11.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti i Arteve ka një zyrë të veçantë informimi për studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve. Siç u konstatua të gjitha syllabuset kanë të detajuar të gjithë infomacionin duke nisur nga ngarkesa, temat mësimore, literatura për çdo temë, frekuentimi dhe procedurat e vlerësimit të dijeve. Çdo pedagog, në fund të syllabusit të çdo lënde ka vendosur edhe mënyrën dhe procedurat e vlerësimit të studentëve, të cilat iu bëhen me dije atyre që në fillim të procesit mësimor. Këtë na i vërtetuan studentët.</p> <p><i>Evidencë Nr. 13. Rregullore e Programit të Studimit, Dokumentimi i vlerësimit të studentëve, Neni 22.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Neni 32, 34, 35 Rregullores së Universitetit parashikon qartë kriteret dhe procedurat e punimit të diplomes për programin Bachelor. Gjithë procedura është mbështetur në nenet dhe rregulloren përkatëse të miratuar nga Senati Akademik.</p>


	<p>Nga stafi akademik na u bë e ditur se për shkak të pas 3-vjeçarit të gjithë studentët i nështrohen provimit të diplomës dhe nuk marrin temë diplome.</p> <p>Nga biseda me studentët na u bë me dije se ka prej tyre që kane mesatare të lartë. Mbetet detyrë e stafit akademik në të ardhmen që ta shohi me prioritet punën me studentët për hartimin e një mikroteze diplome.</p> <p>Evidencë Nr. 13. Rregullore e Programit të Studimit, Neni 32, 34, 35</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Sektori i Komunikimit është hallkë kryesore e Drejtorise së Burimeve Njerëzore që merret me organizimin e takimeve të hapura, bashkëpunimet me zyrat vendore arsimore për ti motivuar matruarantët që të zgjedhin këtë program studimi. Organizimi i panairove është një mekanizëm tjetër i përzgjedhur për informim. Gjithsesi, shqetësimi i shprehur dhe nga stafi akademik është numri i pakët i studentëve që ndjekin këtë program studimi, kjo për shumë arsye objektive. Ky shqetësim na u paraqit dhe nga Dekani i këtij Fakulteti. Politika e institucionit që ka në thelb promovimin dhe reklamimin e këtij programi, mund të pasurohet. Përfshirja e studentëve në programin Erasmus+ dhe mundësisë së ekperinces së një viti akademik ne një nga universitet me të cilat ka marrëveshje mund të joshte maturantet. Faqja zyrtare www.uart.edu.al, panairot e organizuara nga MAS, si dhe faqja më e re e informimit matura shtetërore, në portalin U-Albania të administruar nga Zyra e Sektorit mësimor në bashkëpunim me TI dhe informimit, japin informacionin e duhur ku në kohë reale kandidatët pyesin dhe marrin përgjigje për secilën problematikë të ngritur prej tyre.</p>			
Konkluzione	GVJ konstatoi se ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x

Standardi V.3	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit në institucion GVJ konstatoi se, instiucioni përpiqet të informojë në mënyrë të hollësishme për strukturën dhe organizimin e programit të studimit. Faqja zyrtare web e universitetit përcjell të gjithë informacionin e nevojshëm për çdo student duke filluar nga rregullorja, oragnizimi dhe kohëzgjatja. Gjithashtu ka koordinim të punës së përgjegjësit të departamentit dhe sekretarisë mësimore përkatëse me zyrën e studentit për takime informuese. Koordinator i studentëve luan</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




	rol thelbësor në informimin e studentëve. Për programin dhe praktikat profesionale.			
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ konstaton se informacioni i nevojshëm për programin, procesin, rregulloren dhe aktivitet ofrohet për studentët edhe në llogaritë e tyre elektronike, apo në format të printuar të vendosur në mjediset e hapura të universiteti. Siç referuam dhe më sipër, studenti informohet me detaje dhe në syllabuset e lëndëve përkatëse.			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	<p>Sipas RVB, studentët e UART janë të përfshirë edhe në jetën artistike kulturore të vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në ekspozita dhe aktivitete të tjera artistike në institucionet kryesore të Tiranës (Galeria Kombëtare e Arteve) apo galeri të tjera private. UART ka realizuar me institucionet kulturore artistike në kuadër të iniciativës “Paktit për Universitetin”.</p> <p>Alumni, Zyra e Këshillimit dhe stafi akademik janë si urë lidhëse për orientimin e tregut të punës. Në të ardhmen menohet të jenë urë lidhëse në punësim e studentëve, apo ndonjë studim konkret për këtë urë lidhëse. Një studim më i hollësishëm në të ardhmen i tregut të punës do të ndihmonte në një bashkëpunim më cilësor.</p> <p><i>Evidencë Nr. 6. Udhëzimi i MAS nr. 52, dt. 03.12.2015</i></p> <p><i>Evidencë Nr. 20. Marrveshje e UART me Ministrinë e Kulturës në kuadrin e iniciativës “Paktit për Universitetin”.</i></p>			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<p>Sistemi Pitagora krijon mundësi informacioni të hollësishëm për studentët. Që në momentin e parë ata pajisen me username/ fjalëkalim duke përfutur dhe akses për leksionet dhe informacion shtesë informacionet. Gjithashtu, rol në informimin e studentëve kanë dhe stendat informuese në hapësirat e veçanta të universitetit.</p> <p><i>Evidencë: www.uart.edu.al</i></p>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	<p>Sistemi i menaxhimit u ofron mundësi aksesimi shumë të lehtë studentëve duke u dhënë mundësi informacioni dhe në distancë. Faqja zyrtare e web dhe llogaritë zyrtare në rrjetet sociale të universiteti janë një nga format e përditësimit të informacionit në kohë reale.</p>			
Konkluzione	<i>Universiteti i Arteve vë në dispozicion të studentëve informacion për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës u konstatua që institucioni disponon të gjitha statistikat vjetore për studentët, si në kualifikimin dhe regjistrimin tërheqjet, largimet e mundshme e deri në cilësinë e diplomimit. Duke iu referuar numri të regjistrimit të studentëve vihet re, një numër konstant. Numri i studentëve ka qasje pozitive. Numri i ulët vjen dhe si rezultat i vendosjes së kriterit të mesatares së vendosur nga MASR-ja për programet e mësuesisë.</p> <p>Mbajtja e statistikave të studentëve mbahet edhe në Sektorin e Statistikave, pjesë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në UART.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Institucioni disponon të dhëna dhe statistika për numrin e studentëve, këto të dhëna janë të ruajtuara në të tri format hard copy të regjistrave dhe regjistrat në formë elektronike.</p> <p>Në sekretarinë mësimore janë të depozituara dokumentacionet e plota për numrin e studentëve të diplomuar për çdo program studimi. Sekretaria ka</p> <ul style="list-style-type: none"> – Regjistrin themeltar të studentëve – Regjistrin e lëshimit të diplomave – Regjistrin me të dhënat akademike (regjistri i notave) <p>Sipas të dhënave të marra nga Sekretaria mësimore, numri i studentëve që ndjekin programin e studimit MA në “Skulpturë dhe Mësuesi” është si më poshtë:</p> <p>Viti akademik 2020-2021 – 7 studentë të regjistruar</p> <p>Viti akademik 2021-2022 – 4 studentë të regjistruar</p> <p>Viti akademik 2022-2023 – 8 studentë të regjistruar</p> <p>Në takimin me sekretarinë mësimore u informuam se regjistrat në formë të shkruar depozitohen me kohë të pacaktuar dhe arkivohen në arkivën e shtetit.</p> <p><i>(Evidencë RVB, Takimi në Sekretarinë mësimore).</i> <i>Evidencë Nr. 52. Të dhëna nga sekretaria mbi Studentët e Masterit bazuar në Regjistri Themeltar, Regjistri i Arritjeve Akademike, Regjistri i Lëshimit të Diplomave.</i> <i>Evidencë Nr. 48. Rregullorja e Sekretarive mësimore</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni konservon të gjitha informacionet e ecurisë së studentit nga momenti i regjistrimit deri në lëshimin e diplomave, i cili realizohet në formën hard copy dhe në regjistrin elektronik. Bazuar në</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Statut të Unversitetit. Të dhënat e studentëve sigurohen dhe ruhen në bazë të parimit të konfidencialitetit.			
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njërive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritet mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Informacioni statistikor ruhet në Sistemin Pitagora dhe secili pre studentëve ka një dosje në këtë sistem por, studenti humb të drejtën e aksesimit menjëherë pasi përfundon programin e studimit. Referuar dhe praktikave të universiteteve europiane, emaili dhe fjalëkalimi janë përherë të aksesueshëm dhe një student mund të tërheqë elektronikisht listën e notave në sistemin elektronik kundrejt një pagese. Do të ishte pozitive që kjo praktikë të përfshihej edhe në këtë program studimi.			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Referuar Udhezimit nr.5 të MASR-së, institucioni bën raport vjetor analitik për profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje të një programi.. gjate takimit me studentët u vu re se disa prej tyre dëshironin dhe kishin pasur impakt pozitiv nga praktika profesionale. Ky infomacion sjell nevojën e një studimi më të hollësishëm të tregut të punës dhe bashkëpunimi me shkollat, ku studentët po kryejnë praktikat profesionale për vazhdimin e bashkëpunimit dhe mundësisë së punësimit po në këto institucione arsimore. Do të ishte një masë ndihmuese dhe shërbente për një raport të plotë periodik për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve nga ky program studimi.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x


Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Aktet nënligjore të Ligjit të Arsimit të Lartë, 80/2015 statusi dhe rregullorja e miratuar kërkon përfshirjen e studentëve në strukturën e Senatit Akademik, Këshillit të Etikës, Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Institucioni parashikon angazhimin e studentëve me përfaqësues të zgjedhur nga Këshilli i Studentëve në çdo instancë qeverisëse.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

65



	<p><i>Evidencë Nr.7. Statuti i UART Kreu IX, neni 126</i></p> <p><i>Evidencë Nr.11. “Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e FAB”, neni 56 pika a dhe b</i></p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Me vendim të Senatit Akademik Nr 22, datë 07.10.2021 është miratuar Rregullorja e Komisionit të marrëdhënieve me studentët. Gjatë bisedës me studentët u konfirmua se studentët përfaqësohen në proceset vendimmarrëse në organet drejtuese përmes përfaqësuesve të zgjedhur prej tyre. Studentët e universitetit ishin pjesë e grupit të punës për vlerësimin e brendshëm. Puna e tyre ishte fokusuar në gjurmimin e studentëve të punësuar nga ky program studimi.</p> <p><i>Evidencë Nr.50.1. Sondazhet e bëra nga Sektori Mësimor, stud. dhe ped.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Gjatë konsultimit me dokumentacionin u konstatua se institucioni ka në vëmendje përmirësimin e programit të studimit dhe ngarkesën akademike të studentëve. Studentët kanë të drejtë të transferojnë kredite duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike. Përgjegjësi i departamentit, koodinatori i studentëve dhe sekretaria mësimore bashkëveprojnë për kryejën e këtij procesi, por më parë studenti duhet të plotësojë një formular aplikimi. Gjithashtu, universiteti parashikon edhe një numër të caktuar të studentëve të trojeve dhe studentët që kanë përfunduar studimet e arsimit të mesëm të lartë jashtë kufijve por, me parë duhet të njohin këtë diplomë në institucionin përkatës.</p> <p><i>Evidencë Nr.50.1. dhe 50.2. Sondazhet e bëra nga Sektori Mësimor, pedagogë dhe studentë.</i></p> <p><i>Evidencë, Nr. 50.3. Raporti mbi gjetjet e sondazhit</i></p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentëve ju ofrohet një proces transparent për vlerësimin e dijeve. Në hapësirën personale të sistemit elektronik, ata mund të japin mendimet e tyre rreth procesit të mësimin, gjithashtu kanë të drejtën e ankimimit për vlerësimin e dijes. Mënyra e vlerësimit të studentëve për çdo modul paraqitet në syllabusin përkatës Në rekomandimet e planit të masave për përmirësimin e cilësisë referuar sondazhit të vitit 2020 -2021 i kushtohet vëmendje problematikës për arritjen e dakortësisë të vlerësimit dhe eliminim e presionit të notës por gjatë bisedës me studentët, nuk u shfaq në asnjë rast shqetësimi.</p> <p><i>Evidencë Nr.11. “Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e FAB”, Kreu V, neni 45, pika 12, 13, 14, 15, 16.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se FAB përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, bashkëpunuese për të pasur një marrëdhënie sa më cilësore.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				x
--	--	--	--	---

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni ka si pjesë të strukturës njësitë e posaçme që koordinohen në shërbimin dhe informimin e studentëve sic janë: NjsBC, Sektori i Kurrikulave, Zyra e Shërbimit të Studentëve dhe Sektori i Këshillimit të Karrierës. Procedurat e ndjekura nga këto njësi janë në përputhje me Statutin dhe rregulloren e përcaktuar nga universiteti. I gjithë informacioni i nevojshëm shpërndahet tek studentët në bashkëveprim me Sekretarinë Mësimore dhe Koordinatorin e Studentëve.</p> <p>Në funksion të informimit të studentëve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Zyra e këshillimit akademik që organizon dhe sistemin e tutoratit për studentët e sapo regjistruar. Këshilltari akademik asiston studentët nga momenti i regjistrimit deri tek këshillimi për mundësinë e ndjekjes së programeve të tjera të studimit (master) apo për mundësitë e punësimit. Grupi i tutoratit krijohet nga student të viteve të larta dhe asiston studentët e vitit të parë në adaptimin me sistemin e mësimdhënies dhe akomodimin në UART. – Sekretaria mësimore; është e hapur cdo ditë për studentët dhe ofron shërbim akademik nga regjistrimi në diplomim. – Zyra e studentit; informon studentët për sistemin e bursave, sistemin e akomodimit (konviktet) <p><i>Evidencë Nr.48. Rregullore për Funksionimin e Sekretarisë Mësimore</i> <i>Evidencë Nr.50. Rregullore e Funksionimit të Sektorit Mësimor</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Sistemit të sektorëve të cituar më sipër u shtohet edhe zyra e Alumnit e cila konsiderohet si urë lidhëse midis universiteti dhe tregut të punës. Të gjitha këto hallka kanë në thelb jo vetem informimin dhe këshillimin për programin e studimit por duhet të shërbejnë për orientimin e duhur profesional. Në tërësi kjo njësi, mund të jetë me aktive në ndihmën e ofruar për studentët për krijimin e një profili më të plotë dhe të qartë profesional, që do t'i ndihmonte në krijimin e shumë mundësive për punësim.</p> <p>Institucioni ofron mundësinë e këshillimit të karrieres në zyra e shërbime, e cila ndihmon në zhvillimin social dhe kulturor të studentëve potencialë. Zyra e Këshillimit të Karrierës parimisht jep dhe orienton me informacion për karrirën profesionale.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

67


	<p>Përdoret me efikasitet të plote faqja e web-it të UART si dhe së fundmi sistemi PITAGORA në koordinim të plotë me Rrjetin Akademik Shqipëtar.</p> <p>Në këtë sistem informohen studentët si për rezultatet e tyre ashtu edhe me gjithçka tjetër në lidhje me procesin mësimor.</p> <p>Evidencë Nr.50. Rregullore e Funkcionimit të Sektorit Mësimor</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni ka një zyrë Këshillimi Karriere e cila bashkëpunon dhe koordinon veprimet me hallkat e tjera administrative në rektorat por duhet sjellë në vëmendje gjurmimi i studentëve që kanë përfunduar programin. Zyra e Alumnit duhet të ketë si pjesë të përshkrimit të punës jo vetëm listimin e studentëve që përfundojnë këtë program studimi por edhe këshillimin e studentëve gjatë karrierës së tyre, arritjet dhe pengesat duke i dhënë mundësi krijimit të Alumnit (këtij programi në veçanti).</p> <p>Evidencë Nr.50. Rregullore e Funkcionimit të Sektorit Mësimor Evidencë Nr.12. Rregullore mësimore e ciklit të dytë të studimeve master në Universitetin e Arteve, Neni 40</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Njësia e karrierës mbante kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe ka krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve në institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Këto të dhëna ajo i siguron bazuar në komunikimet e vazhdueshme me ta, nëpërmjet adresave të e-mailit, të dhënave të kontaktit, adresave të rrjeteve sociale, etj. Çdo vit, struktura e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, harton plane dhe raporte vjetore në lidhje me gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar programin e studimit, dhe sipas kërkesës ua vë ato në dispozicion organeve përkatëse.</p> <p><i>Lidhur me këte pikë GVJ sugjeron që jo vetem të listohen emailt dhe numrat e telefonit por edhe arritjet e tyre.</i></p> <p>Evidenca 51. Databaza Alumni.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se UART ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve si dhe menaxhimin e problematave të tyre.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>UART është institucion me status të veçantë dhe ka ndërtuar një metodë specifike për organizimin e çdo moduli. Vetë programi është pjesë e zhvillimit dhe përdorimit të metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies. Sistemi Microsoft Teams i ngritur nga Rektorati dhe sektori i TI, gjatë periudhës së Covid 19, u vendos në dispozicion manuali i përdorimit të këtij sistemi si për pedagogët ashtu dhe për studentët, individualisht apo me grupe të vogla të organizuara në bashkëpunim dhe nën drejtimin e stafit akademik.</p> <p><i>Evidencë 43.2. Manuali i përdorimit të sistemit të Microsoft Teams</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Komisioni i cilësisë monitoron punën sesi janë ndërtuar syllabuset, ngarkesën, shpërndarjen e krediteve dhe mbarëvajtjes së formave të vlerësimit, institucioni përdor tri metoda për kryerjen e procesit të vetëvlerësimit, duke nisur nga raporti vjetor, pyetësorët me pedagogët dhe ndryshimet e programeve të mbështura në VKM-të dhe udhëzimin përkatës.</p> <p><i>Evidencë 50.1. Pyetësori për pedagogët</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Referuar Statututit të UART, Neni 123, Institucioni përdor si metodë të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të cilësisë anketimin e studentëve.</p> <p>Përgjegjësi i departamentit përpiqet të kryejë vëzhgime të procesit mësimor gjatë gjithë vitit. Si hallkë e vlerësimit të cilësisë së institucionit përpiqet të përfshijë dhe studentët që kanë përfunduar këtë program studimi (Alumni). Pikë pozitive është integrimi i studentëve të zgjedhur nga Këshilli i Studentëve, në strukturat e cilësisë duke u shpërndarë detyra dhe përgjegjësi. Në vlerësimet periodike studentëve u jepet e drejta të kërkojnë</p> <p><i>Evidencë Nr.7. Statuti i UART. Neni 123, pika 1, 2. Neni 126</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.531, Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë, institucioni përpilon raportin dhe analizën e pyetësorve. Rezultatet e vlerësimit të brendshëm janë transparente. Në raport është respektuar etika akademike, të dhënat janë përcjellë pa shmangur informacione të rëndësishme dhe në bazë të ligjit 48/ 2012 janë repektuar parimet e konfidencialitetit.</p> <p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion në u informuam se strukturat përgjegjëse në fund të pyetësorëve për cilësinë e mësimdhënies bëjnë publik rezultatet e vlerësimit në departament dhe mbi këto rezultate</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

70

	<p>reflektohet në analizën vjetore të punës së departamentit. Studentëve u garantohet anonimatit dhe liria e mendimit në çdo pyetësor.</p> <p>Po kështu në analizën e pyetësorëve është parë gjithmonë me kujdes moscënimi i figurës së pedagogut.</p> <p>Evidencë Nr.50.3. Rezultatet e pyetësorit për studentët dhe pedagogët</p> <p>Evidencë Nr.15. Analiza vjetore e punës në Departament</p>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p>Institucioni përpiqet të organizojë e promovojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies nëpërmjet pyetësorëve, evidenton shembuj të praktikave të mira dhe brenda kufijve të etikës, duke nxitur stafin akademik për përmirësim të proceseve të mësimdhënies, të programeve të studimit dhe të vlerësimit të dijeve sipas kërkesave bashkëkohore.</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton që ky standard përmbushet, por këshillon që në të ardhmen të specifikohet pyetësori për çdo program.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Statuti i UART ka si strukturë kryesore përgjegjëse për sigurimin e brendshëm Komisionin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC). Ky komision bazohet në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kodin e Cilësisë të Arsimit të Lartë, Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit, Statutin e UART dhe është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion. Në takimin me personelin e këtij sektori GVJ u njoh me aspekte praktike të zyrës së kurrikulave pranë kësaj drejtorie.</p> <p>Evidencë Nr.7. Statuti i UART</p> <p>Evidencë Nr.12. Rregullorja mësimore e ciklit të dytë të studimit në UART</p>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e	<p>Institucioni përdor mekanizma e procese të dokumentuara si raporte periodike vjetore, ndërsa Sektori i Sigurimit të Cilësisë ndjek procedurat</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

71

<p>Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>dhe vlerëson mundësinë e riorganizimit të programeve. Shpërndahen pyetësorët përpara çdo sezoni provimesh duke ruajtur anonimatën e studentëve dhe diskutimi i tyre duke evidentuar pikat e dobëta dhe pikat e forta, hartimi i një plani masash për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë në evidencat e paraqitura.</p> <p>Të gjitha këto procese observohen nga komisioni i përbër nga Zv Rektori për anën mësimore, Zv Rektori për projektet artistike dhe shkencore dhe një Përgjegjës nga secili Departament si dhe i gjithë Sektori Mësimor&Kurrikulës.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Metodologjia e përdorur për pyetësorët e studentëve është sasiore dhe është miratuar me vendim të Senatit Akademik, gjithësej 20 pyetje të strukturuar në tri nëndarje lidhur me metodën e mësimdhënies, infrastrukturën dhe bashkëpunimin.</p> <p>Në pyetësor janë përfshirë të gjithë studentët. Gjithsesi mungesa e një pyetësori të profilizuar për specifikën e këtij programi është një hapësirë boshë e cila do të ndihmonte më shumë për vlerësimin objektiv të arritjeve, prishmëritë dhe mundësitë e plotësimit e përditësimit të këtij programi.</p> <p>Evidencë Nr.55. Praktikë ndryshimesh dhe përmirësime programesh</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Referuar procedurës së Analizës së Vlerësimit të pyetësoreve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies, raporti i pyetësoreve me rekomandimet dhe reflektimeve u përcillen strukturave përgjegjëse në universitet. Dokumentimi analitik i rezultateve realizohet nga NJSBC. NJSBC përpilon gjithashtu projektpropozimet dhe rekomandimet mbështetur në analizën e pyetësorëve dhe formularëve të performancës. Raporti i dërgohet njësisë kryesore e cila ia përcjell departamenteve për konsultim dhe reflektim në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p> <p>Evidencë Nr.55. Praktikë ndryshimesh dhe përmirësime programesh</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>


Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Rektorati ka ngritur pranë Drejtorisë së Edukimit, sektorin e Njesisë së Brendshme të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional. Hallkë e sigurimit të cilësisë është dhe bashkëpunim me zv/ dekanët. Më rëndësi është edhe parashikimi për ngritjen e Komisionit të Sigurisë së Cilësisë së Brendshme. Puna e këtij komisioni do përqëndrohej në monitorimin e syllabuseve të programit të studimit dhe raportimin në departament. Raporti mund të ndihmojë në reflektimin dhe në rritjen e cilësisë së syllabuseve.</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Sektori Mësimor dhe i Kurrikulës, organizojnë veprimtari periodike me personelin dhe me studentët për informimin, ndërgjegjësimin dhe trajnimin e tyre mbi sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit nëpërmjet pyetësorëve të zhvilluar për këtë qëllim si me stafin akademik, ashtu dhe me studentët. Komisioni të Sigurimit të Cilësisë monitoronte punën sesi janë ndërtuar syllabuset, ngarkesën, shpërndarjen e krediteve dhe mbarëvajtjes së formave të vlerësimit. Institucioni përdor tri metoda për kryerjen e procesit të vetëvlerësimit, duke nisur nga raporti vjetor, pyetësorët me studentët dhe ndryshimet e programeve të mbeshitura në VKM-ë dhe udhëzimin përkatës.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>UART ka si metodë të drejtpërdrejtë të vlerësimit të cilësisë anketimin e studentëve. Sipas RVB-së kjo procedurë është kryer për stafin akademik dhe studentët, ndërsa studentët konfirmojnë pjesmarrjen vetëm, në një anketim i cili është kryer në nivel fakulteti. <i>Duhet të sjellim në vëmendje mungesën një modeli specifik pyetësori për programin në mënyrë specifike, lidhur me ndërtimin e syllabuseve, pasurimin të tyre, burimet që shfrytëzoheshin, motivimet, përfshirjen e studentëve në programin Erasmus+, motivimin për të vazhduar ciklin e dytë në degën e Mësuesisë, dhe jo në degë të tjera.</i></p> <p>Përgjegjësi i departamentit përpiqet të kryejë vëzhgime të procesit mësimor gjatë gjithë vitit. Si hallkë e vlerësimit të cilësisë së institucionit përpiqet të përfshijë dhe studentët që kanë përfunduar këtë program studimi (Alumni).</p>

	<p>Referuar Analizës së pyetësorëve të stafit akademik, informohem se institucioni vlerëson në mënyrë dhe periodike performancën e stafit akademik.</p> <p>Referuar: Pyetësor për studentët 50.1pdf</p> <p>Analizës së pyetësorëve të stafit akademik 50.2 pdf</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>UART më kuadër të vlerësimit përpiket të hartojë një politikë të qartë të sigurimit të brendshëm të cilësisë Në Statutin e universitetit përshkruhen procedurat që ndiqen duke nisur nga hartimi i rregullores, pyetësoreve në funksion të komisioneve dhe autoriteteve dhe studime të gjurmimit të ecurisë së studentëve. GVJ inkurajon përpilimin e rregullores së NJSBC dhe zgjerimin e këtij sektori në një hallkë më të rëndësishme.</p> <p>Konkretisht departamenti i paraqet procedurat për përmirësim dhe ndryshim për ciklin e parë dhe të dytë Evidencë Nr.15.1. Raportet vjetore të departamentit (tre vitet e fundit) për analizat e punës për procesin mësimor, programeve të studimit, rezultateve të vlerësimit dhe masave të marra për adresimin e mangësive.</p> <p>Platforma ALUMNI (http://uart.edu.al/index.php?id=845)</p>			
Konkluzione	<p><i>Lidhur me këtë standard, GVJ konstaton që është plotësuar, por është e këshillueshme që pyetësori të specifikohet me çdo program studimi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Rektorati ka ndërtuar pranë Drejtorisë së Edukimit, sektorin e Njësisë së Brendshme të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional. Hallkë e sigurimit të cilësisë është dhe bashkëpunim me zv/ dekanët. Më rëndësi është edhe parashikimi për zgjerimin e kësaj njësie edhe me formimin e komisioni që ndihmon në Sigurimin e Cilësisë së Brendshme. Monitorimi e syllabuseve të programit të studimit dhe raportimin në departament. Raporti mund të ndihmojë në reflektimin dhe në rritjen e cilësisë së syllabuseve.</p> <p>Evidencë Nr.50.2. Pyetësori për studentët</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

74

	<p><i>Evidencë Nr.50.1. Pyetësi për stafin akademik</i></p> <p><i>Evidencë 12.2. Raportet vjetore për analizën vjetore të punës</i></p> <p><i>GVJ duke iu referuar numrit të programve sugjeron zgjerimin e kësaj njësië cila do të ndihmojë në shumë llojshmëri të raporteve pasurimin me raporte, reflektime që do të ndikojnë në rritjen e cilësisë së m;simdhënies dhe në ngritjen e një Komsioni të Cilësisë.</i></p> <p><i>Evidencë Nr.50.2. Pyetësi për studentët</i></p> <p><i>Evidencë Nr.50.1. Pyetësi për stafin akademik</i></p> <p><i>Evidencë 12.2. Raportet vjetore për analizën vjetore të punës</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Refruar modelit të evidencave të paraqitura rreth metodës dhe kriterëve që janë ndjekur për të monitoruar punën sesi janë ndërtuar syllabuset, ngarkesën, shpërndarjen e krediteve dhe mbarëvajtjes së formave të vlerësimit, institucioni përdor tri metoda për kryerjen e procesit të vetëvlerësimit, duke nisur nga raporti vjetor, pyetësorët me studentët dhe ndryshimet e programeve të mbështetura në VKM dhe udhëzimin përkatës.</p> <p><i>Evidencë Nr.50.2. Pyetësi për studentët</i></p> <p><i>Evidencë Nr.50.1. Pyetësi për stafin akademik</i></p> <p><i>Evidencë 12.2. Raportet vjetore për analizën vjetore të punës</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmëskadematik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni përdor si metodë të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të cilësisë, anketimin e studentëve. Sipas RVB - së kjo procedurë është kryer së fundimi në gusht të 2022, NJSCB punon që studentët të konfirmojnë pjesmarrjen, gjithashtu edhe stafi akademik.</p> <p><i>Duhet të sjellim në vëmendje që ka një model specifik pyetësi për programin mësimor dhe një pyetësor tjetër për stafin akademik.</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Referuar modelit të pyetësorëve të ngarkuar dhe analizës së bashkangjitur u vu re që ishin respektuar integriteti akademik duke shmangur paragjykimet apo diskriminimin. Në pyetësor ishin evidentuar dhe shënuar të gjitha mendimet qoftë pozitive, negative lidhur me infrastrukturën, metodat e mesimdhënies, motivimin për kërkime shkencore, hapësirat dhe mundësitë komunikimi me stafin akademik.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin</p>	<p>UART ka të përfshirë në Statut, Rregullore dhe në Planin strategjik për sigurinë e clësisë së brendshme edhe politikat për përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Në përbërje të NJSBC-së ka student apo përfaqësues të jashtëm. Përfshirja në projekte që janë të fokusura në sigurimin e cilësisë së brendshme, trajnime për përshtatjen e programeve</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	me tregun e punës. Gjithë informacionet e paraqitura nga departamenti janë premtuese, por janë ende në fazën e dokumenteve.			
Konkluzione	<i>GVJ shpreset se Institucioni ka përfshirë personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit MA në Skulpturë dhe Mësuesi dhe ka informuar drejtuesin e UART në lidhje me rezultatet e dala nga këto procese.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Referuar Satusit dhe Rregullores, një nga strategjitë e institucioni në kuadër të sistemit të sigurisë është edhe ngritja e komisionit Ad Hoc, i cili ka në përbërje dy zv/rektorët e UART.</p> <p>Ky komision menaxhon sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion, aktiviteti i së cilës synon përfshirjen e numrit sa më të madh aktorësh të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Të gjithë anëtarët angazhohen më tepër në drejtim të përmirësimit të cilësisë së mësidhënies në gjithë elementët përbërës të saj, ndërsa anëtarët e tjerë japin ndihmën në drejtim të përshtatjes së programit të studimit me kërkesat e tregut të punës. Gjatë takimit me personelin u informua se Manualin e Sigurimit të cilësisë shërben për mbarëvajtjen e punës së këtij sektori.</p> <p>(Evidencë Takime në institucion; Marrëveshjet në kuadër të Erasmus+)</p>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<p>Gjatë takimit GVJ u informua se përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë dhe strukturat e angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë janë të përcaktuara në dokumentet bazë si Organizimi i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>Komisioni i Sigurimit të Cilësisë dhe Sektori Mësimor dhe i Kurrikulës, anëtarët e këtij komisioni dhe këtij sektori, kanë përgjegjësi dhe detyra konkrete dhe të ndryshme, në përshtatje edhe me rolet që ata kanë në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Pikë pozitive është integrimi i studentëve të zgjedhur nga Këshilli i Studentëve, në këto</p>


	struktura duke u shpërndarë detyra dhe përgjegjësi. Gjithsesi, studentët duhet të jenë më të qartë për detyrat e tyre në këtë komision.			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	<p>NJSBC funksionon në nivel institucioni dhe koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në të gjitha njësitë kryesore. Në mungesë të një zyre të sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel fakulteti, ky funksion është realizuar nga dekanati i cili bashkëpunon dhe shkëmben informacion me NJSBC për problemet e cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Vlerësimi i sigurisë dhe i cilësisë kërkon dhe bashkëpunimin dhe përfshirjen e gjithë aktorëve të departmentit dhe personelit ndihmës akademik që nga drejtoria e kurrikulës, drejtoria e edukimit. Sekretaritetë mësimore kanë statistika të plota dhe të detajura për arritjet e çdo studenti në këtë program studimi.</p> <p><i>(Evidencë RVB; Takime me GVB)</i></p>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	<p>Njësisë së Sigurimit të Brendshëm përveç stafit akademik, si pjesë përbërse e të përzgjedhur konsiderohet si pikë pozitive integrimi i studentëve për vetë specifikën e programit, art dhe mësuesi duke shmangur çdo lloj diskriminimi në formë apo në përmabajtje.</p> <p>Studentëve u garantohet anonimatit dhe liria e mendimit në çdo pyetësor. Po kështu në analizën e pyetësorëve është parë gjithmonë me kujdes mosçënimi dinjiteti i figurës së pedagogut.</p> <p><i>Evidencë 67. Kodi i Etikës i UART</i></p>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<p>Integritetit të grupit të vlerësimit të brendshëm, universiteti përpiqet të përfshijë dhe faktorë të tjerë në proceset e vlerësimit për të siguruar mundësinë e më shumë opinioneve për të përmirësuar cilësinë e programeve duke angazhuar gjithë faktorët.</p> <p>Ekspertiza dhe sugjerimet e tyre vijnë nëpërmjet tryezave të rumbullakëta, aktiviteteve të përbashkëta, mbledhjeve etj. Në këto rast është konsideruar me prioritet opinionin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për të vlerësuar dhe pasqyruar elementë që lidhen me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se NJSBC ka organizuar të gjithë hapat e nevojshëm për të ndërtuar një hapësirë e cila reflekton pikat e forta dhe të dobëta të institucionit, të cilat nevojiten për të reflektuar. Lidhur me rëndësinë e këtij sektori, numrin e fakulteteve dhe ngjeshjen e detyrave, GVJ sugjeron zgjerimin në një hallkë më të madhe.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Arteve
“Skulpturë Qeramike dhe Mësuesi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë
“Universiteti i Arteve ”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit Master i Arteve në “Skulpturë Qeramike dhe Mësuesi” gërsheton kreativitetin dhe edukimin e mendimit të pavarur.
2. Staf i akademik plotëson kriteret e nevojshme përsa i përket përgatitjes shkencore, por identifikon thelb të punës së tij marrëdhëniet në formë mentorimi pedagog- student.

Pikat e dobëta:

1. Referuar ngarkesës mësimore, organizimit dhe rëndësisë së moduleve në këtë program të ciklit të dytë identifikojmë që moduli “Vlerësim në Arsim dhe Zhvillim Kurrikule” ka si vlerësim përfundimtar, vetëm firmë. Për vetë rëndësinë që ka ky modul në profesionin e **Mësuesit** është e nevojshme të konsiderohet që të kalojë në provim me sezon.
2. Databaza e Alumnit ka vetëm një listë emërore. Kjo listë emërore duhet të ketë si prioritet plotësimin me të dhëna të punësimit apo arritjet artistike të studentëve që ndjekin këtë program studimi (Standardi V.6, Kriteri 4).

Rekomandime:

1. Referuar Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe takimeve në institucion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm sugjeron përmirësimin dhe zgjerimin e numrit të laboratorëve. Zgjerimi do të ndikonte në përmirësimin e infrastrukturës, cilësisë së mësimdhënies dhe mundësisë që studentët të kenë hapësirë më shumë për të realizuar punimet.
2. Shtimin e burimeve financiare për botimet shkencore të stafit.
3. Prioritet duhet jetë edhe bashkëpunimi me të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar, me qëllim që të hartohet një studim i plotë i tregut të punës.
4. Rekomandohet që webfaqja të ristrukturohet e të ridizenjohet që të jetë më koherente dhe përmbajtja të jetë edhe më e plotë në mënyrë që të interesuarit të pajisen me të gjitha informatat përbrenda saj.
5. Softueret grafikë që kanë kompjuterat në laborator të jenë të përditësuara në mënyrë që studentët të jenë koherent përsa i përket edhe trendeve softuerike për të krijuar vepra dixhitale multimediale.
6. Të ketë një arkiv për pjesën e grafikave e veprave të tjera që janë realizuar nga profesorët e studentët përgjatë viteve e të cilat secili student apo hulumtues që është i interesuar të ketë qasje më të lehtë dhe arkivi të jetë i mirëmbënuar që të bëhet edhe në mënyrë elektronike që qasja t’i ofrohet përmes internetit çdo të interesuari.

**Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Arts in
"Ceramic Sculpture and Teaching" provided by the Higher Education Institution
"University of Arts"**

Strengths and affirmations:

1. The Master of Arts study program in "Ceramic Sculpture and Teaching" creates the possibility of interweaving creativity with the education of independent thought.
2. The academic staff fulfills the necessary criteria in terms of scientific preparation, but the essence of its work is identified with the teacher-student mentoring relationship.

Weaknesses:

1. Referring to the teaching load, organization and importance of the modules, we identify that the module "Evaluation in Education and Curriculum Development" has only "firm" as final evaluation. Due to the very importance in the teaching profession, it is necessary to be considered passing of this module in a seasonal exam.
2. The Alumni database is simply a list of names. This list of names should have as priorities the completion of employment data or the artistic achievements of the students following this study program.

Recommendations:

1. Referring to the Internal Evaluation Report and meetings in the institution, the External Evaluation Group suggests improving and expanding the number of laboratories. The expansion would affect the improvement of the infrastructure, the quality of teaching and the possibility for students to have more space to carry out their work.
2. Increasing financial resources for staff scientific publications.
3. Cooperation with all institutions of pre-university education to prepare a complete study of the labor market should also be a priority.
4. It is recommended that the website be restructured and redesigned to be more coherent and the content to be even more complete so that those interested are provided with all the information within it.
5. The graphic software on the computers in the laboratory should be up-to-date and coherent with the current part so that students are coherent in terms of software trends to create multimedia digital works.
6. To have an archive for the part of the graphics and other works that have been realized by the professors and students over the years, to which every student or researcher who is interested can have easier access and the archive should be well thought out to be done in a way electronically so that access is offered via the Internet to anyone interested.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

